

## INTERVISTË ME NAXHIJE BUÇINCËN

Prishtinë | Data: 12 dhe 14 qershor 2013

Kohëzgjatja: 67 minuta

Të pranishme:

1. Naxhije Buçinca (E intervistuar)
2. Anita Prapashtica (Intervistuesja)
3. Emine Berisha (Intervistuesja)
4. Donjetë Berisha (Kamerë)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Fëmijëria

**Emine Berisha:** Zonja Naxhije a mund të na flisni për fëmijërinë tuaj?

**Naxhije Buçinca:** Fëmijëria jeme kryesisht prej lindjes nuk ka qenë e kandshme deri në një kohë, deri me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Jam e lindur në Ulqin, me 15 prill 1935, nga baba Hodo, Hodo Beg Ulqini, dhe nga nana Meleqe Lazoja. Deri në atë moment kur shpërthej lufta, familja jem ka qenë shumë e kandshme, shumë normale e rrethuar prej dashurisë dhe kujdesit prindor maksimal. Ngaqë kemi qenë prej atyne familjeve që ka qenë mire ekonomikisht, kanë qenë të pasur dhe kryesisht nuk më ka mungu kurgja, sikur mu edhe krejt vllazënve e motrave të mija. Mirëpo, me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, që u ba një shkatërrim total edhe e quajnë botërore, u trazu shumë familja jeme, jo vetëm e jemja po të gjitha familjet që kishin një trend të zhvillimit ekonomik korrekt, u shkatrru.

Kështu u shkatrru edhe familja jeme, ngaqë u ndërruan sistemet dhe ideologjitë. Prej një sistemi demokrat që mund të thojmë atëherë ka qenë demokrat, edhe ishte demokrat me të vertetë, kaluam në një sistem totalitar; totalitar domethënë komunist. Ne atë sistem na nuk i takonim se veprimtaritë tona ishin shumë demokratike ishin të përkushtume. Prindët e mie të përkushtuem çështjes kombëtare, dhe ishte dhe momenti dhe atmosfera që të realizonim shumë të drejta si komb në atmosfere demokratike. Te gjitha ato u ndërprejnë me ardhjen e sistemit komunist.

Kështu që familja ime pësoi trauma të randa, pësoi ramje drastike ekonomike ngaqë u plaqkitëm komplet nga ky sistem, dhe na u desht të ikim ose të lëshojmë vendin tonë, duke gjetë strehë sepse i takonim një republike tjetër; padrejtësisht, duke gjetë strehë që ne menojsim edhe e kishim deri atëherë; atdheu jonë Shqipëria. Megjithatë u befasuam se na, edhe në Shqipëri ishte një sistem totalitar në krye me Enver Hoxhën, dhe ishim të padëshirushëm, ideologjikisht ishim të padëshirushëm ngaqë ne nuk i takonim asaj rryme. Kështu që na u desht ilegal të jetojmë në Tiranë, një kohë të gjatë. Jo me emrin Alibegu, sepse nuk pranojshin asnjë kastë ose klasë shoqërore ngaqë këta i zhdukën klasët. Ajo ishte një zhdukje imagjinare, sepse megjithatë nuk u zhdukën klasët.

Mbetëm anonim si familje në Tiranë. Kështu që edhe baba ikën prej regjimit komunist malazez, se aty kishim dy armiq, ideologjinë! Por si komb kishim edhe popullatën malazeze që s'pranonte veprimet tona për çështjen kombëtare, dhe për jetën tonë si pakicë në Mal të Zi. Jo pakicë mrena Ulqinit, po pakicë mrenda republikës së Malit të Zi. Kështu që ishim mes dy zjarreve dhe ne kryesisht në ilegalitet kemi jetu. Mirëpo megjithatë punonte shërbimi shtetnor, si i Malit të Zi edhe se kishin të njejtën ideologji, diktun [kuptuan] se ku po jetojmë. Baba rrinte në arrestin shtëpiak dhe askush nuk dinte për të, ngaqë edhe axha edhe baba ishin dy figura të njoftuna se Cafabeg Ulqini edhe Hodobeg Ulqini; bile axha ishte pjesëmarrës i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kështu që, na u kërkonim edhe si familje po edhe si veprimtar edhe baba edhe

axha. Diktun [kuptuan] se, na bastisën shtëpinë para syve të mi, para syve të mi e arrestuan babën. Kjo ishte gjaja ma trishtuse, nuk e kuptoja se isha në shkollë fillore, çka po ngjet [ndodhë] megjithatë e disha që diçka e pakandshme ne do të na gjej herët a vonë.

Dhe me burgimin e babës në Tiranë thanë, “Ju do të deportoheni për Jugosllavi”. Atëherë ju thonin Mal të Zi domethonë, do të shkoni se nuk jeni shtetas shqiptar, i takoni Malit të Zi. Edhe, na u kthym në Ulqin, po ku u kthym në gojën e ujkut u kthym. Rrishim si anonim edhe të izoluar edhe në Ulqin, ngaqë të gjithë kishin frikë prej këtij sistemi dhe se shqiptarët, për shqiptarë kjo ishte një kohë shumë e pakandshme sepse ishim tjetër nacion, tjetër konfeksion dhe e papranushme për Malin e Zi dhe çdo lëvizje për të tregu identitetin tonë u gjykonte edhe u dënonte.

Kështu që, shkollën fillore e kryva në Tiranë dhe u donte [duhej] shkollimi i mesëm dhe ishte çudi se në vitin 1948, masi u deportu në burgjet e Podgoricës baba, e dënun si nacionalist se ngriti flamurin në kishën e... Se ne kishim shumë tolerancë, por në kishën katolike ngriti flamurin shqiptar. Dhe ai për shkak të asaj ngritjes, veprimtarisë të babës po edhe pse ishte shqiptar, e dënun me vdekje pa asnjë argument tjetër përveç se ishte shqiptar; dhe që kishte luftu për identitetin e vet shqiptar të kombit të vet. Dënohet me vdekje dhe pushkatohet në Podgoricë. Kjo ishte një humbje e madhe për nanën teme, për familjen teme por edhe për të tjerët që na takojshin si familje. Megjithatë ne u izoluar shumë, dhe mjetet për jetesë ishin shkatrru, e çdo gja, çdo pasuni ish konfisku, shkatrru deri në maksimum.

Nana kishte ruajt veç stolitë e saja, me ato stoli ne jetuam një kohë të gjatë, por dajhtë i kishim në gjendje ekonomike të mire. Natën na sillshin ushqimin për të mbijetuar këtë situatë. Kështu që, jemi rritë me trauma të randa. Ajo që ka qenë ma e traumatizuar ka qenë motra e madhe se ka qenë madhore, 18 vjeçare, vllau pak më i ri se ajo, vllau tjetër i madh mbeti në Shqipëri; ngaqë e kërkonin atë se ishte 19 vjeçar, e kërkonin edhe atë për pushkatim. Ai met ilegal edhe krejt kohën ka qenë në Shqipëri deri në 2005 ku ai ndërroi jetë 81 vjeçar; 40 vjet s’kena pasë kontakt me të deri sa u hapën kufijtë.

Kështu që gjithë kjo jetë ka qenë trishtuese. Megjithatë, kur baba shkon në... bile kam qenë prezent në gjykimin, si fëmijë i vogël jam përvjedhë [kam hyrë fshehurazi] nuk e disha çfarë po thojnë, nuk e disha serbishtën si duhet. Veç, e mbajta mend gjykimin e tij. Ai tha, “Smer, streljanje” [Kahja, pushkatim] që domethënë gjykimi i tij, ose vendimi i gjykatës është të pushkatohet. Dhe erdha ja dhash lajmin nanës. Nana megjithatë merrte vesh edhe kto ma të mdhajtë mershin vesh se çka osht’ ajo. Ajo nuk u trazu shumë, mirëpo kishte drejtë me u taku prej së largu me babën dhe baba e jep një porosi. Tha, “Mos u trondit”, tha “të lutem i ke fëmijët në dorë, m’i shkollo fëmijët dhe m’i drejto nga Kosova”. Kufijtë në ’48-tën u mbyllën dhe ne plotësisht u izoluar prej shtetit amë. Tha, “M’i shkollo dhe m’i drejto ka Kosova, se tani atdheu i jonë duhet të jetë Kosova”.

Nana e përmbushi atë edhe pse ishte si tona nanat në atë kohë, ajo kishte disa klasë të mejtepit [shkollë fetare] atëherë nifar shkollimi, por ishte shkollim fetar. Ajo i mbajti ne mend mirë ato fjalë dhe të gjithë na shkolloi. Detyrë e kishim katër prej nesh ishim, përveç atij që mbet në Tiranë, vllaut të madh, katërve prej nesh ishim orientu në arsimimin. Ishte motra e madhe, ajo kreu shkollën normale në Tiranë, derisa unë kryva shkollën fillore, dhe u kthy, edhe ata e deportuan në Mal të Zi, u ba mësuese dhe na orientoi.

Vazhdoi motra si ma e madhja vazhdoi punën e nanës, me iniciativën e nanës që ne të shkollohemi. Dhe si të shkollohemi kur ne serbo-kroatishten nuk e dishim. Edhe pse ishim në mesin... 85 përqind ishin shqiptarë në Mal të Zi, ishim të lidhur, kufijtë ishin gjithmonë të hapur me Shqipërinë, nuk e dinim. Akoma ishim të vegjël, çdo gja ishte shqip në atë periudhë demokratike që mund t’i thojmë dhe ishte ajo periudhë. Kështu që ne thamë edhe s’do të na shkollojmë; çudi e madhe qysh kemi hi në kombinim. Unë

motra ime edhe vllau të shkollohem në gjuhën shqipe. Dhe me gjithë 15 të tjerë nga fshatrat edhe na prej Ulqinit, na mbledhën e na dërgojnë, ne nuk mundëm të shkonim as në Podgoricë të shkollohem as në Cetinë, as në Ivangrad...

## Rinia

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për rininë e saj.]*

**Naxhije Buçinca:** Pasi që nuk kishim mundësi, i treguam që ne s'mujmë. Jo vetëm ne që ishim armiq të popullit, na quajshin ne fëmijët e një të pushkatuarit, siç ishte pushkatimi i babës. Ishin edhe fëmijët tjerë nga fshatrat, dhe bashkë me ta u futëm edhe ne në atë kombinim, dhe na dërgun në Gjakovë në shkollën normale. Ishte kënaqesi e madhe (buzëqeshë) edhe herën e parë ishte çudi të njohë një pjesë të botës teme shiptare në një territor krejt të ndamë, dhe aty u shkolluam si unë dhe vëllau, edhe motra në Mitrovicë; pastaj, dhe në 1954 shkolla normale e Gjakovës transferohet në Prishtinë në qendër. Dhe diplomuam në 1954, diplomova në shkollën normale. E para gjeneratë, e dyta kryesisht, e dyta gjeneratë që po kryen shkollën normale të plotë me katër vjet; sepse atëhere kryesisht u përgatitëshin kuadra shpejtë e shpejtë me kurse të ndryshme. Me kurse të ndryshme u përgaditëshin, dhe kjo ishte e para shkollë e rregullt katër vjeçare që përgatitëshin për profesionin e mësuesit.

Dhe unë e pata edhe një intervistë disa gazetarë të Kosovës më intervistun dhe deklarova, unë do të bahem mësuese e popullit, dhe u ktheva në trevën e Ulqinit. Mirëpo atje më priti prapë armiqësia, të gjithë mashkujt fituan, tjerët që s'ishin të familjës time fituan Ulqinin, kurse mu më transferuan në vendin ma të largët ku mundet me qenë. Ajo që një lloj dënimi, po për mu ka qenë prioritet i madh sepse isha në një vend shumë piktoresk, ishte një vend i imi, buzë liqenit të Shkodrës, qendra ishte Ostros, dhe të gjithë qytetarët më njifshim e kujt jam, prej çfarë familje po vjen. Po ishte një çudi e madhe, femna e parë mësuese mbërrijta unë, e bija e Hodobegut ka ardhë mësuese në Ostros.

Ishte kënaqësi e madhe aty filloi puna jeme për arsimin e femnës shqiptare, meqë nuk e lejojshin kurset analfabetike, por kurset shëndetësore. Dhe unë ç'bëj? Kurset shëndetësore kyresisht i lejonin, unë duke i mësu për qështjen e shëndetit, me ato broshurat që ata na i servojshin, unë krahas hapa kurset e analafabetit dhe pata shumë sukses sepse ato u mbanin se... kishin shumë besim në mu, u mbanin në shpia private. Edhe kurset shëndetësore, po kyresisht kishin shpia private dhe unë aty kam pasë tetë qendra, tetë fshatrat kryesore ku gravitojshin edhe këto lagjet pak ma të largëta, gravitojshin në këto fshatra. Dhe, ishte një kënaqësi e madhe se ishte etnikisht e pastër, s'kisha nevojë ta përdorja edhe gjuhën serbo-kroatishte meqë e kishim në program në sistemin arsimor të asaj ish-Jugosllavie të krijuar në atë kohë mas Luftës së Dytë Botërore. Kështu që puna jeme për arsimin e femrës ishte prej 1954.

Mund të them që 60 vjetori daton ajo, derisa një dorë, një dorë e mirë shumë, jo që më grabiti, po që ish dakord shumë, takova Fahriun në shkollën normale bashkë ishim në mature. Ishte shok i mirë i vëllaut dhe aty u krijua njëfar simpatie, unë e dojsha si shok s'ma merte mendja që mund ta marr bashkëshort të jetës. Megjithatë me kënaqësi të madhe unë u largova sepse pata shumë shqetësime të mëdha nga sigurimi shtetëror i Malit të Zi. Sepse kur morra letërnjoftimin e parë dhe aty u majta afër pesë-gjashtë orë në sigurim, dhe u donte të deklarohem çfarë jemi, thash, "Jam shqiptare". "Jo", tha, "ka kalu ajo koha që ti të jesh shiptare, tash nuk është koha e Shqipërisë". Domethanë ajo koha që unë e përjetova si demokraci, edhe pse nuk disha se isha fëmijë. Tha, "Nuk ka ma shqiptare, ti je malazeze", thash "Unë nuk jam kurrë, s'kam qenë as s'do të jem kurrë malazeze", edhe tha, "Mbiemrin çfarë e ke?" E dinin mirë çfare

kam, thash, “E kam Alibegu, Alibegaj...” , “jo”, tha, “mbiemri yt duhet të jetë Alibegoviç”. Thash, “Kurrë për këtë dynja nuk do ta vë atë ‘viç’ përmbra”, thash “M’falni, përndryshe nuk e marr kurrë letërnjoftimin”.

Dhe ata me telefona me... s’di çka, kam qenë veç pesë-gjashtë orë kam ndejtë derisa u brengosën shumë familja jeme pse mbeta aq gjatë aty. Meqë e dishin se edhe kur u lajmërova si mësuese, tha, “Prej çfarë shpije je ti, nuk e meriton as atje me shku në Krajë, nuk e meriton me u punësu fare”. Dhe nuk pranova, mirëpo çuditërisht nuk e di pse, do të mundohem ta tregoj edhe atë letërnjoftim nese ka me u demonstru, e kam letërnjoftimin, dhe megjithatë e shkruan Naxhije Alibegaj, nacionaliteti “shiptarka” dhe e kom datën se kur ma dhanë. Mirëpo, unë pata shumë shqetësime mandej, shumë përplasje, shumë ndjekje. Kështu që dora e Fahriut ishte koha që unë të largohem prej Ulqinit patjetër. Edhe ashtu që pësonte shumë familja, po edhe unë pësova shumë personalisht shumë, dhe zgjatja e dorës së Fahriut ishte zgjatja shpëtimtare e qenis teme. Megjithatë unë thash duhet të vazhdoj misionin tem, sepse edhe Kosova ka shumë nevojë për mësuese dhe unë do t’i bashkohem burrit tem si mësuese, edhe ai ishte mësues.

Dhe për t’a ilustru këtë gjatë asaj kohe kur ne, ishte një kohë e përshtatshme, para Luftës së Dytë Botërore. Axha ishte një anëtar i këshillit të lartë të Shqipërisë dhe ai solli të gjitha tokat shqiptare bashke, nxiti që ministri i arsimit i Shqipërisë të dërgojë n’të gjitha tokat shqipëtare etnike afër 460 mësues prej Shqipërisë. Ku ata, kjo ishte para luftës dhe gjatë luftës, ata ishin shumë të koncentrum në Ulqin, bile në sangjakun e Novi Pazarit kena pasë shkollën Naim Frashëri në atë kohë dhe në Kosovë. Për këtë gjest të ministrit të arsimit, axha i dhuroi një tokë ministrit të arsimit për të ndërtu një vilë ministri i arsimit. Ishim shumë falenderues, që ministri i arsimit, Ernest Koliqi bani për të gjitha tokat etnike që ishin jashtë shtetit shqiptar. Kjo ishte një prioritet i madh për Kosovën; dhe për të gjithë tokat shqiptare siç ishte në Mal të Zi, Tuz, në Mal të Zi komplet Ulqini, Tuzi, po edhe tokat tjera që mendonim që gjoja se i takonin territorit të Shqipërisë.

Ne sangjak të Novi Pazarit u hap shkolla shqipe sepse gjithë ato tokat ishin tonat. Kështu që filloi një arsimim i mirëfillt, mirëpo, me ardhjen e luftës, ndërrimin e sistemit, megjithatë u shkatërruan dhe u larguan, disa edhe mbeten, siç kemi profesor Mehmet Gjevorin, e kemi 60-70 vjet punoi për çështjen e arsimit; prej asaj kohe prej para lufte mbeti. Ai krijoi edhe familjen këtu, i ka vajzat, djemtë, mbesat. Jeta është njëra prej gazetarëve që është mbesa e Mehmet Gjevorit. Kështu që, une mendoj me ardhjen në Kosovë, shtrimi i asaj dore që thash të Fahriut, kisha mjaft hapësirë edhe mundësi, po edhe hapësirë, edhe nevojë të punoj në atë drejtim për shkollimin e vajzave. Domethënë fokusi im është shkollimi i vajzave.

Këtu gjeta një atmosferë shumë të kandshme se isha mes të mijve, megjithatë, çdo ndryshim që ban, ose çdo pjesëtar që mendon ndryshe, ka kulturë ndryshe, për çdo gjë qëndrimi i vëmendjes time ishte njeriu, edhe mund të bashkëpunonim edhe me ata që nuk ishin të kombësise teme. Ne erdhëm prapë në një rreth ku serbët ishin të privilegjum. Mirëpo këtu ishte dashtë të luftoj nën një sepse kombësia tjetër që ekzistonte që nuk ishte në shumicë, këtu nuk ishte shumice, ishte pakicë. Ajo ishte pjesa e privilegjume domethënë na ishim të diskriminim më një kohë, ashtu siç e lashë Ulqinin gjeta edhe Kosovën në atë kohë sepse ishte një sistem totalitar komunist. Por, fokusi ishte lufta kundër një popullate shumicë se janë ba projekte të tëra për zhdukjen e shqiptarve nga Kosova.

Mos t’i numërojmë kush kanë qenë autorët, ishte një luftë e madhe për ekzistencë si identitet shqiptar, por ishte luftë edhe për arsimim, sepse dhimta ma e madhe e pjesës tjetër që nuk i takonim ne, atij nacionit ishte të mbes shqipëtarë sa ma i pashkolluar. Dhe kjo ishte një luftë se unë kur u martova në ‘60-tën. ‘59-‘60 ishte martesë jeme, nuk e gjeta bash në situatë të lakmueshme, se këtu mos të flasim

historikisht se çfarë ngjau me mbledhjen e armëve, me braktisjen e shqiptarve, duke braktisë se nuk është ky vend i shqiptarve se këta janë myslimanë e do të ikin në orient, do të ikin në lindje. Unë momentalisht kam prezent kunatin tem e kunatën që para 40-50 vjetve me dhunë janë shpërngulë prej trevave tona. E sot tash ata frymojnë dikun larg po janë jetojnë bashkë me ne. Momentalisht i kam prezent në këtë kohë unë që po intervistoj.

Domethonë puna jeme akoma vazhdoi që sidomos pika ma neurologjike është shkollimi i vajzës, sepse ne përjetuam një mentalitet patriarkal, pastaj dhuna ishte, dhuna permanente sidomos nëpër fshatra; sepse këtë luftë që e kemi shumë të freskët '99-shin, për shqiptarin u përjetu me ardhjen e komunizmit si sistem. Programi i tyre ishte zbrazja e Kosovës prej shqiptarve. Kështu që kisha terren të volitshëm për një punë që si mision i'a kisha dhanë vetës qysh prej ditëve të para të shkollimit tim.

Rrëfeva shumë gjana të fminisë, një pjesë e bukur e fminisë, po edhe ajo trishtuese. Megjithatë më kujtohet diçka prej fminisë që ka qenë e kandshme për mu. Dhe meqë jetojshim në bashkësi axha me familje dhe baba, ishim një familje e madhe. Gjyshin nuk e kam përjetu, a gjyshën po. Ka qenë një grua me shumë autoritet dhe shumë e kanë ndëgu djemtë, se ka pasë dy djem e dy vajza, po ajo ka jetu me djemë. Edhe një ditë më thotë se isha ma e vogla si duket, si duket edhe ma e shkathëta, thotë, "Naxhi shko atje poshtë në kru [te kroi] mbushja axhës brokën [bokallin] me ujë të freskët". Unë veç e shikova kështu, "Unë s'po ja mbushi babës tem, e po ja mbushi axhës". Si duket ajo ka qenë shumë gja e randë për gjyshën time edhe ka qenë shumë çudi, si kam mujt me i thanë unë këte fjali që s'po i'a mbush babës e po i'a mbush axhës. Si duket unë si fëmijë e kam analizu pastaj edhe vetë, nuk kam dashte autoritete, kom qenë shumë anti-autoriteteve, nuk i kam duru autoritetet. Dhe ajo tha, "Ti ki mu ndëshku për sonte." Nana, megjithatë, i'u duk simpatike pse refuzova, se isha fëmija gjithmonë anon ka ai ma i afërti, axha ishte për mu sikur diçka i largët në krahasim me babën, se i dhashë prioritet babës. Dhe më ban me sy kh tu {hap sytë} "Ikë pak, ma vonë harrohet kjo". Gjyshja m'u kërcnu tha, "Kur të zbresë axha poshtë e shef, për me pi ujin e kështu, e shef çka të gjen". Unë bana bisht menjëhere, ika në lagje kisha aty edhe do shoqe edhe kjo punë sikur u harru. Ajo u kërcnu kështu po me siguri që ke na s'ka pas ndëshkim fizik për fëmijë. A oral ka mujt me qenë gjithmonë me disiplinë fëmijën, ishte dashtë edhe ai ndëshkimi oral.

Edhe një rast shumë simpatik më kujtohet, menoq në atë jetën teme djallëzore ka pak si fëmijë. Në oborr të shtëpisë e kemi pasë një dud, mana i thojshim ne, dhe lakmojsha gjithmonë ato ma të mdhajat me mujtë me i vjelë. Dhe e shiqoj që nana ishte në kuzhinën verore t'u fërgu peshk. Mendojsha që nuk do më lejoj me hypë në manë [pemë] dhe shkova prapa, tërthorazi prapa, se ishte si aneks i shtëpisë, prapa mbi atë, se ishte kollaj të hypësh prej rrugës që ishte anësore të hypësh mbi pullazin e asaj kuzhinës verore. Ajo kuzhina verore ish improvizuese, dhe unë a është që do të qëndroj si peshë a jo, synimi ishte me marr manin ma të madh atje. Edhe kadal ty bo hapat, më lëshon një drrasë mu afër ku ishte nana ty fërgu peshkun. Ajo tremet thotë, "çka nodhi?" edhe unë në dy kamt kam ra, edhe bisht kam ba. Tha, "Kjo ma edhe n'kry me ra, n'kamë ka me ra; në kry t'kish ra n'kamë kish ra". Edhe kam ba bisht, ika se do të më bërtite, "Eja të pastë nana eja se shyqyr që ra n'kamë e nuk ra nrysh [ndryshe] e nuk u lëndova, prandaj mos u tremb se kurgja s'kam me t'ba". Kshtu edhe kjo ishte një episodë e kandshme e jetës teme si fëmijë.

Domethanë prej atyne hapave, unë tan kohën jam shoqëru me djemë, edhe kur bojshim lojë të djemve, shiqoni me çfarë terme ka qenë titulli i lojës, "komitë dhe xhandarë", merre me mend, komit domethanë i ikur që del në mal, komit-rrebel, dhe xhandar. Dhe unë gjithmonë isha komiti, rrebeli, edhe ma vonë të gjithë shokët më thirrshin "Naxhi djali", se tan kohën me djemë lujsha po edhe shoqet e mija tanat të ndrojtuna, jo me djemë nuk luhet se ajo është lojë djemsh. Edhe ma në fund më kryqëzuan [emëruan],

“Naxhi djali”. Kështu që tan kohën ka qenë po afër meje ka qenë gjithmonë edhe vllau, se me moshë kena qenë afër shumë njani-tjetrit, një vjet kena pasë diferencë, edhe kudo që ishte shkathtësi diçka me nga [vrapi] me arritë dikun atë rol e lujsha unë. Këto ishin këto tri raste të fëmijësisë time që më kujtohen me andje dhe e gjithë kjo lojë u lunte në pishat e Ulqinit buzë detit. Ato tallazët<sup>1</sup> më kanë përcjellë në t’mirë në t’keq, m’kanë shti në gjum dhe kam nostalgji të madhe, sidomos në kohë të kësaj moshe. Kam nostalgji po jam e lidhur me Ulqin, se çdo vjet shkoj dhe kam një shtëpizë të vogël shumë modeste që çdo vjet e shfrytëzoj atje në Plazhën e Madhe.

Unë e spjegova pak femininë mirëpo duke u rritur, në familjet patriarkale ka diçka që stagnon zhvillimin e femnës sa i përket si pjesëtare sociale e një shoqërie. Unë e maj në mend që nana jeme ka qenë e para që ka dalë në kostim [kostum banje], edhe në pllazhë, mundeni me marrë me mend. Dhe ajo ish trashëgu tek ne dhe kanë thanë njerzit ka dalë gruaja e Hodobegut ka dalë në plazh, sepse na vizitonin një klasë e naltë e Shqipërisë, Tirana, Shkodra sidomos. Vinin tek ne ato gra bashkë me nanën dilnin n’kostime, kostime të lamjes, dhe kur ne vazhdum edhe pse ishim të okupum, kur ne vazhdum këtë avaz, që t’dalim si vajza se nana tash ishte në atë pjesën e pleqërisë mund të them, relativisht e mplakur, vajzat vazhdun të dalin në pllazhë.

Dhe një ditë më rrëfen Drita Gunga, një mikeshë e jema e afërt veprimtare e shkëlqyer, me keqardhje e them se është e smutë, ajo më rrëfen thotë, “Kur isha në Ulqin, isha mysafire e një familje” edhe i thotë shoqja e vet, në familje e pranon, edhe i thotë Drita, “Na mund të dalim në pllazhë, t’shkojmë në pllazhë?” Gjysha e asaj mikeshës vete i thotë, “Ku doni me dalë moj ju?” “Po n’pllazhë me shku me u rrezitë m’u la në det.” “Rri moj vajzë rri në vend aty ku jeni po çfarë t’daluni ju!” Po thotë qe, “Naxhi e Hodobegut, e Dilaveri e Hinda ato po dalin”. “A din kush janë ato bre? Ato janë vajzat e Hodobegut. Ju doni m’u krahasu me ata, doni me dale në pllazhë ju? Atyne i ka dalë nana në pllazhë, i ka hije me dalë edhe kta.” Unë atë episode që ma tregoj Drita që me keqardhje e thom, që dëshiroj shëndetin e saj, Drita Gunga, kur ma tregoi që merre me mend, që nuk isha edhe koshient që mendimi i të tjerëve ishte që për familjën tonë ishte e pranueshme, se kemi një nivel si duket evropian, dhe e pranueshme për të gjithë ka qenë ajo. Mirëpo, kjo ishte edhe një rrugë që e hapshim që edhe tjera vajza të na bashkohen ne në pllazhë. Nuk ishte vetëm çështja e pllazhës, po ishte hapja e rrugës që femna duhet të shkojnë barabartë me mashkullin.

Që tash më kujtohet kur Igo [Rogova] tha në atë mramje kur ishte promovimi i fondacionit për shkollimin e vajzave “Çifti Buçinca”, se çifti Buçinca ishte shembulli i barazisë gjinore se tash e kemi ba këtë çështjen e barazisë gjinore se flasim tan kohën. Po, flasim, mirëpo a po na ngjan në realitet a jo, do shofim ma tutje, po, edhe osht ba edhe si modë të flasim per barazinë gjinore. Ajo na morri si shembull ku dy bashkëshortët janë të barabartë në ship, shoqëri dhe kudo.

Po du me thane që edhe në atë pjesë të Ulqinit kemi... nje familje patriarkale. Po ashtu gjeta edhe në Vushtrri një familje tw atille patriarkale ku ish mu duk se jam në Mesjetë, po kishte brenda për brenda një qytetërim, jo të msheftë po si anonim një qytetërim, një sjellje qytetare në atë qytet. Kështu qe me impononte, mirepo une prape çaja rrugen kah lirimi i femres. Edhe aty bona nje gjest qe nuk ... me mentalitetin patriarkal qe kishim aty; por natyrisht me mbeshtetjen e Fahrise se kisha nostalgji me shtetin e Fahriut, kisha nostalgji per detin dhe ai thotë, “Ne e kemi Sitnicën”. E unë kur shkova mu m’u dukë Sitnica si diçka e vogël fare, megjithatë atë nostalgji do t’a plotësoj, do t’a kem... do t’notoj. Dhe shkuam bashkë, shofim asnjë femër s’ka, isha e vetme gru, hajt vajzë, gru isha e një bashkëshorti qytetar i lindur i

<sup>1</sup> Romanisht. Talaz: valë, dallgë.

Vushtrrisë. E u futa në ujë, kur po shoh prej një shenje, mashkujtë ndoshta ma të rinjë ose ma të vjetër se unë u hidhnin, bajshin sallto në ujin e Sitnicës. E mata e ishte mjaft thellë, se nuk ishte uji si i detit, osht' uji i ambël edhe u futa t'a shiqoj, si me shiqu diçka t'çuditshme që ka ardhë prej s'nalti dika. U futa t'a shiqoj, jam largu edhe kur pe shiqoj si me shiqu diçka t'çuditshme si me ardhë prej s'nalti dika. U futa në shenjë, edhe çfarë poze kam marrë, ne i thojmë "dallëndyshe" me krahë ashtu, për mrekulli se une kisha msu në det aty ku jom rritë. Dhe, të gjithë tan kohën osht' folë gruja e Fahri Buçincës po lahet në Sitnicë dhe hidhet në kry prej shelines {improvizon me dorë hedhjen}. Edhe ajo ka qenë një shpërthim, si me thane çkado që e bon mashkulli, mund t'a boj edhe femra.

Kam dhanë një sinjal, ka qenë një sinjal për të gjithë dhe kom pas përkrahjen të nxanseve të mija, i kom dhonë msim atyne prej shkollës fillore edhe ma tutje. Kam pas përkrahje, i'u ka pëlqy çdo gja. Kanë qenë t'ngurta po i'u ka pëlqy çdo gjest që osht' ba në avansimin e pozitës së saj, edhe në familje edhe në shoqëri ka qenë e pranushme. Mirëpo, për disa konservatorë ajo ka qenë e papranushme, mirëpo duhet të theksoj një burrë-hoxhë, Mikullovc, bile djali i tij ka qenë drejtor i "Grand-it" para se të privatizohej, menaxher. Ai me simpati më nalte edhe fliste me mu, ai ka qenë për arsimim, shumë ka dhanë për arsim, thotë, "Shumë më pëlqen gjestet që i bon ti, je shumë e pranushme për mu". Kur t'a thotë një njeri si hoxhë se u mante [mbahej] edhe si autoritet; domethanë përveç burrit fitova edhe një mbështetje të madhe te një gjeneratë që nuk ishte afër meje kërkun. Domethanë që e pranushme për njerëz që e dijnë çka osht' përparimi që e çmojnë arsimimin, çmojnë përparimin, unë isha e pranushme edhe për atë gjeneratë, nuk mund të them se isha një individ. Megjithatë ndikonte një familje, ndikonte një mentalitet. [I drejtohet të pranishmeve] E hoxhë Mikullovc i kanë thane, apo?

Kshtu që, më jepte kurajo të vazhdoj pavarësisht thashethemeve se përcillen kto gjana, pastaj implikimet e ndryshme. Megjithatë unë thojsha, "Koha do të tregojë sa kom të drejtë", e a kom të drejtë? edhe çdo ditë e bindsha veten që kjo rrugë që kam, kjo osht' rruga ma e drejtë për çlirimin e femrës prej mrapa-mbetunisë, prej mentalitetit patriarkal.

Martesa jeme ishte '59-'60. Në '60, me 5 gusht, linda Gencin. Genci më bëri nënë, ishte një ngjarje e papërshtatshme për mu. Krijova familjen me fjalë të tjera, kam një fmi, unë jam nanë. Edhe pse vuajta gjatë shtatzanisë ishte kënaqësi kur ti në një moment bohesh nanë. Ma tutje menova, që me një pauzë t'vogël prej tri vjetëve në '63-shin, me 1 shkurt linda Xheraldinën. Xheraldina osht' lind në një kohë aq të ashpër dhe aq... '63-shi ka qenë, klima në një shkurt... Në atë kohë s'kemi pas mjete jo taksi e kto. Pajtonat kanë qenë ato që na kanë qu në destinacion, në martenitet. Derisa Genci u lind, kisha vështirësi, materniteti nuk ishte aq i përgatitun në Vushtrri, unë linda në Prishtinë dhe ai thotë, "Mirë kam ba që jom lind në Prishtinë" e i thotë Xherit, "ti ke lind në Vushtrri". Mirëpo në '63-shin ishte rregullu materniteti, ishte një mami e Shkupit shumë e mire, kishte Fahriu besim në te. Atë doktoreshën që rrinte në kujdesin e saj, Fahriu e kishte mike, thotë, "S'ke nevojë me qu n'Prishtinë, kjo do të lindet këtu". Dhe kom lind në Vushtrri, po një vajzë e fuqishme me një killazhë [kilogramë] normale prej katër kilogramësh po ashtu edhe Genci, dhe unë kisha dy fmijë.

Ishte kënaqësi kur dy gzime i pata, një që u bana nanë, Genci më bani ate, dhe e dyta që unë doja edhe një vajzë, dhe e fitova - Xherin. Ishte kënaqësi për mu si familje se të dy gjinitë osht' mire me i pas. Mirëpo, për me i pas të dy gjinitë në një rreth ku kishim mentalitet patriarkal nuk ishte aq lehtë sepse edhe mentaliteti infiltrohet edhe në familje edhe n'qëndrimet e rrethit. Dhe Genci t'u u rritë kishte shoqinë e caktume të tij dhe bonin vizitë sikur ata shoktë e vetë, po edhe ky shkonte në shoqni të shokëve të vetë. Dhe ai ka vërejtë një ditë, mes të tjerash me nifar fuqie, s'di rasisht ni ditë i thotë Xherit, "Xheri ma jep një gotë ujë". "A ke dur ti, a ke kamë? Merre e kurrë mos ma kërkë gotën e ujit prej meje". Ai metet, shok për te ishte,

mos me ndëgju motra, ngaqë mendonte se të gjithë motrat e shokëve të vetë, le që i shërbenin gotat me ujë, i'a shtrojnë edhe shtratin edhe i qesin çajin edhe të gjitha ato shërbime, kjo për një gotë ujë me çfarë arrogance sillet me mu; se ai mendonte, si shokët e vetë, si mashkull duhet me qenë dominant n'raport me motrën e vetë. E unë nuk mund të i'a spjegoja barazinë gjinore- teori, por me zbutë këtë gjë se ky ish proces i gjatë thash, "Nan osht' pak horre ajo arroganca", thash, "Po leje, tash osht' futë n'pubertet". Tha, "A di çka nanë? Unë e morra vesh kur ish futë n'pubertet, po kur do të del prej ktij?" (Qeshë) Edhe une meta, me t'vërtetë meta e habitun, një buzëqeshje e përcjelli gjithë këtë, thash, "E shofim na, kadal kadal edhe kjo rregullohet". Me fjalë të tjera donte djali me tregu që unë duhet me u trajtu prej motrës seme siq trajtohen shokët e mi prej motrave të tyne.

Kjo ishte ajo që u dallonte në familje, u dallonte prej hapave të parë. Prej hapave të parë fillonte ajo barazia gjinore që qitash me të madhe flasim se përpara as s'e kemi përmendë barazinë gjinore, as s'kemi ditë a osht' barazi gjinore. E kemi ditë që padrejtësitë i bahen femrës, por që janë programe të tilla, përmisime të këtilla se s'mund të përmisohen pa kalu një kohë e gjatë, pa kalu shumë mentalitete, pa u ndrru gjeneratat e ndryshme, pa u arsime nuk mund të arrihet asgjë. Se edhe me programe, e me debate t'thata nuk ndrohen se çdo ligj që arrihet, çdo ligj që aprovohet në Kosovën tash të çlirume, çdo ligj duhet të ketë patjetër mbështetjen materiale për t'u realizu, përndryshe metet ai ligj pa u implementu, pa u zbatu sepse çështja ishte... Ishim në një takim të Rrjetit [Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës] ku suedezet si duket e banë atë sondazh ku ka mrri shoqëria kosovare në barazinë gjinore, ishte bo zbatimi i ligjit. Ligjet janë sjellë, bukur çdo gjë osht', zbatimi osht' problemi ma i madh, edhe për barazinë gjinore po edhe për çdo gjë që e rrethon jetën shoqërore sociale, politike, ideologjike, ekonomike osht' moszbatimi i ligjeve.

Kështu që u shkolluan të dy, djali ishte ma i prirun ka astronomia që s'kishim mundësi, atëhere duhej të shkollohej jashtë. Megjithatë, një vizitë që bani vllau jem i ndjerë tha, "T'pastë daja, unë t'kshilloj, unë nuk i'a imponojsha, unë t'kshilloj të bahesh një mjek i ardhshëm". Dhe ai me respektin që kish për dajën e vetë tha, "Unë do t'shkoj n'mjekësi". Ishte nxanës i shkëlqyshëm, provim pranus prej nxanësve t'shkëlqyshëm krejt jetën prej shkollimit fillor dhe të mesëm, pa asnjë katër. Tha, "Unë do t'shkoj, të regjistrohem në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë", dhe ai shkoi sikurse qitash që e kanë provimin pranues se ishte me të gjitha notat shkëlqyeshëm. Dhe vazhdoi në medicinë pa e dashtë fort, megjithatë kishte një sens t'hollum për diagnozë. E dinte çka, për shembull kur punonte në praktikën me pacientë shumë i'a qëllonte, domethanë kishte diçka një sens të veçantë të tij që mund të diktonte se çka, me një spjegim shumë të shkurtë me ditë se çka një person ankohet se çfarë sëmundje mund të ketë.

Mirëpo, ranë kto në '86-tën diplomoi dhe u martu, ka dy fëmijë si rrezja Ermali dhe Lurni dhe të dy studenta të mirë shumë, t'shkëlqyshëm t'them. Dhe nuk i osht' nda profesionit të vetë, megjithatë sot udhëheqë një kompani prestigjioze e Bosnaljekut të Bosnës, si menaxhues ma i miri në region. Kjo ishte jo menimi, po qëndrimi i qendrës që e kanë në Sarajevë dhe për atë shkak i'a dhanë me menaxhu degën në Shqipëri, kështu që e menaxhon Kosovën dhe Shqipërinë dhe osht një menaxhues i shkëlqyeshëm. Nuk i osht' nda mjekësisë, se ktu ka punë me barna kryesisht, mirëpo shumë jep për specializime të ndryshme që kërkojnë mjekët, i sponzorizon për avanzimin e profesionit që ai praktikisht nuk osht' t'u e praktiku, po osht' hala t'u punu për atë çështje. Kolegët e vetë, kolegët e rinjë që janë, ai osht' i gatshëm gjithmonë që me i sponzorizu nëpër kongrese e pjesëmarrje të ndryshme nëpër botë, sepse në kongrese njifen me gjana t'reja, zbulime t'reja. Megjithqë interneti ka ba shumë në këtë pikëpamje dhe ai momentalisht osht' t'u i menaxhu si menaxhues i shkëlqyeshëm.

Xheraldinën unë menoj që duhet letërsi, mirëpo kishte prirje për letërsi sepse prej moshës të vogël, pesë vjeçe në '68-shin, ajo mson një poezi për Skënderbeun. Shtatë strofësh, pesë vjeçe e majti n'mend të gjitha duke ushtruar me mu se ishte manifestimi i 500 vjetorit të jetës së Skënderbeut dhe figurës së Skënderbeut. Pesë vjeçe recitoi për mrekulli dhe një kompozitor i dhuron një tufë lulesh dhe e përgëzoi për talentin e saj sesi ajo e tha poezinë, e tha shumë bukur. Mirëpo ajo ishte një krijuese e vogël që une e kom vërejtë tek ma vonë, kur ajo u fut në klasën e parë, filloi të shkrujë. Ajo shtazët i ka shumë qejf, poezinë e parë i'a dedikoi qenit, një krijese një shtaze me t'vërtetë e afërt me njeriun shumë. Dhe, kur na recitonte, Genci ndonjëherë, "Hajde shkruaj edhe për macën", thotë, "Qenin e kryve, hajde tash për macën". Mirëpo ajo filloi seriozisht të krijojë dhe i ka tri-katër botime, i ka edhe në anglisht të përkthyer. E ka një botim tash, një përmbledhje poezish, mirëpo osht' pak dembele që nuk don fort jo me punu, se ajo punon në atë drejtim mirëpo me i publiku... rrin si anonim, ajo osht një poete Ali Podrimje se takoheshim me Aliun në Ulqin, në takime verore të Ulqinit ku shumë shkrimtarë kosovarë i prezentojshin punimet edhe tha, "Naxhi, une në përmbledhjen e poezive si antologji, t'vetmen femër e kam fut se e vetmja femër poete osht' e nivelit t'largë ktu në Kosovë". E mendimin e Ali Podrimjes e kam vlerësuar shumë, ish poet numër një. Me keqardhje që osht' i ndjerë, mirëpo jeta e tij, krijimtaria e tij akoma vazhdon. Ishte një kompliment i madh për mu dhe menjëherë i'a transmetova Xherit që t'jetë ajo stimul, që kjo t'vazhdojë me krijimtarinë e re. Osht' i gatshëm libri, kjo nuk don me e botu, po me ato përamasat që ajo i cakton e botuesit dojnë vetëveten, natyrisht ka ato kriteret e veta, kështu që megjithatë osht' një poete shumë serioze. Bash korrekte, osht' shumë korrekte në paraqitjen e saj si poete, si n'anonimitet nuk osht', po krijon, akoma krijon.

Është një zavends drejtoreshë t'kompanisë prestigjioze të Televizionit 21 që e themelun bashkë me Afërdita Saraçinin si drejtoreshë, kjo zavends drejtoreshë. Kto dyjat e fillun krijimin e këtij televizionit dhe patën shumë suksese. E udhëheqin, kanë një staf të shkëlqyshëm ekipor punon në ekip, mirëpo ish meritë e Afërditës, Xherit, Florinit, Eugenit që ky televizion ka arritë aty ku osht' sot. Xheri osht' edhe një trejnuese e mirë e gazetarëve. Para disa ditëve pat disa trajnime, trajnon çështjen e komunikimit do ta ketë edhe me gratë deputete, se si duhet deputetet të komunikojnë. Çdo gja, njeriu nuk mundet me trashëgu prej diçkafit po msohet, çdo gja që përpiqesh me ba e mson edhe e arrin. Kur të msojsh, arrin të jesh qajo që kërkohet prej teje.

Të dy janë të sukseshëm, i du shumë. Edhe një gja, i'a kom rritë... të dyve i'a kom rritë fmitë. Edhe Gencit i'a kom rritë fmitë. Edhe Xherit i'a kom rritë Ledrin. Ermali osht' një arkitekt, ka qelë zyren e vetë me një shok, Lurni osht' në vitin e katërt në AUK. Ledri si e dini, momentalisht osht' asistenti i parë i Isa Qosjes në regjinë e filmit "Tri dritare dhe një varje". Është një temë shumë interesante, si të dhunuarat gjatë luftës... mos të hy tash në komente... si të dhunuarat që kanë metë anonime, ngaqë janë dhunu prej pushtetit të egër serb, po përjetojnë dhunimin e dytë prej rrethit ku jetojnë. Kështu që nuk kërkohet prej tyre se çka do t'flasin, po kërkohet se si i ka pranuar ky film, paraqet si rrethi i ka pranuar ata. Është një privilegj që Ledri punon me Isa Qosjen meqë krejt familja e Ledrit tash merret me artin. Ai është marrë me artin bashkëkohor, rinor, hip-hop. Tekstet i bon gjithmonë vetë, gjithmonë i ka ba. Nuk domethonë që ka hekë dorë prej kësaj pune, po nuk don ma të angazhohet nëpër koncerte, po don të krijojë, ose të bojë spote me tekste që i ka të përgatituna. Besoj që në të ardhmen, kur të kryjë master, se tash është në master... e ka fitu master sepse e ka pas mesataren 9,6 është t'u punu me një regjisor numër një të Kosovës, Isa Qosja.

Lurnin e presim edhe atë të bëhet një... e ka mediat dhe menaxhmentin, t'bahet edhe ky një ekspert. Të dy, të tre janë të mirë, unë i rrita, i ndihmova (buzëqeshë). Mos t'thom se i kanë pas prindët e vetë nanën e babën, po edhe Xheri me Agronin. Mirëpo, i ndihmova në rritjen e tyre se sot edhe nana edhe vjehrra janë

të nevojshme për ndihmesë sepse asht' ndrru sistemi i jetës. Mas lufte, krejt isha shndërru sepse gruja që punon nuk mund të jetë e përkushtume shumë familjes po duhet, është e përkushtume punës që punon punës jashtë, për të arritë atë që ajo mendon që duhet me arritë. Kshtu që kam qenë ndihmesë e krah, bile kanihere i'a kam vjedhë kohën edhe Xherit edhe Gencit edhe nipave duke u përkushtu misionit tem kryesor që ka qenë shkollimi i vajzave shqiptare.

## Aktivizmi

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për periudhën e aktivizmit.]*

**Naxhije Buçinca:** Po kjo puna jeme që thojnë, unë e kam qu një punë si çështje patriotike se na ishim në nifar mënyre të okupum nga sistemi komunist. Nuk ishim bash të barabartë dhe të jetojmë të barabartë, po kjo jetë më ka ndërtu edhe ma heret ku e spjegova shkollimin dhe fëmijërinë time. Ka vazhdu edhe kur kam ardhë në Kosovë në Vushtrri, ka vazhdu reagimet e mia, ku u cënonte e drejta e shqiptarëve e kombit tem. Kshtu që unë se kom qujtë jetë politike, po e kom qujtë një jetë ku secili njeri duhet të mbrojë kombin e vetë, do të mbrojë çështjen e asaj popullate që i takon sepse ajo ishte e cënume, ajo ishte e kërcënume, ajo ishte e abuzume në shumë mënyra. Kshtu që unë nuk i thojsha që ish një lëvizje politike e jemja, ose një veprim politik i jemi sa për mu ishte ma e pranushme një punë patriotike, detyrë e secilës pjestar që përjetonte të gjithë atë... sidomos mas ardhjes në pushtet të Millosheviçit.

Kshtu që, kam psu disa paknaqësi të mëdha nga veprimet e mia se në '68-shin festova në shkollë kur isha, festova 28 Nëntorin. Ku një nxanse e jeme e shkëlqyer - Mirvete Badivuku Pantina, doktor i shkencës sot, mësoi poezitë e Lasgush Poradecit "Bijnë Telat"<sup>2</sup>. Ajo flite për 28 Nëntorin, pavarësinë e Shqipërisë që ishte pavarësi edhe për ne, po e papërjetume fare se s'guxojshim as ta përmendnim ne, as Shqipërinë po as flamurin. Dhe, në '68 une e festoj klasë më klasë, të veshun vajzat, edhe Xheraldina në '68-shin deklaroi e foli atë poezinë për Skënderbeun. Ishte e veshun me fustanin e kuq, e shqiponja e zezë anash. Ashtu edhe nxanset e mija, n'krye me Myrveten, Myrvete Badivuku... prej klase n'klasë, pa i marrë leje drejtorit. Drejtori ishte si një person politik, e shiqonte politikën dhe mbronte natyrisht, mos t'thom kauzën, po mbronte vendin e tij si drejtor. Nuk e përfilla fare. U festu ajo edhe kishim edhe ..... aty edhe ata u ngritën, "Çka osht' kjo? Ku mund të përmendet Shqipëria?" Dhe u ba një problem komunal, po ajo shkoi ma tutje edhe në Kosovë. U formu komisioni për diferencim se isha anëtare e Partisë, por interesont thote dikush, "A ju që keni qenë nëc Parti!" Thash, "Na e kena pas ma vshtirë që kemi qenë në Parti për me e mbrojtë çështjen tonë, kauzën tonë. Se jena ballafaqu me probleme t'mdhaja dhe kanë pasu me përjashtim nga puna." Si edhe ndodhi.

U formu komisioni, mirëpo megjithatë shqiptarët ishin edhe ata në politikë. Dijshin se diçka po ngjetë që nuk duhet të ngjajë, pasi kishim edhe intelektualë kanë kry punën e tyne ashtu si duhet. Ishte një mbrojtje e madhe e Azem Shkrelit shkrimtari, e kam çmue si krijues të ndjerin. Ai e gjithë biseda që ishte, shkante ka ajo që unë duhet të përjashtohem prej pune. Kur u përjashtojsh prej Partisë, automatikisht dilshe prej pune. Dhe, ishte ndihma e pakontestueshme e Azem Shkrelit që e falemnderoj, edhe pse ishte i ndjerë ai është një figurë e shkëlqyeshme e letërsisë tonë. Dhe pastaj pasun edhe t'bamet t'tjera.

Ishte edhe ajo kur rezhimi i Millosheviçit ishte aq i egër sa preku sistemin shkollor tonin duke eliminu çdo gja që ish shqiptare, duke i futë orët e serbishtës ma tepër sesa t'shqipes, edhe aty kam reagu, por ishte '81-shi kur lëvizi faktori rinor, gjithmonë ka qenë revolucionar (buzëqeshë). Dhe tash u mbajshim mbledhjet e partive, diferencimet, të gjitha ato t'pabamet që ishin ndaj popullit tonë. T'bamet, t'pabamet

<sup>2</sup> Titulli i saktë: "Bjenë Telat"

t'popullit tonë dhe aty mbrojta haptaz lëvizjen studentore të '81-shit. Ta mbrojsh në atë kohë ishte sikur me i'a nënshkru vetëvetit jo përjashtimin, po edhe burgun e merrshe. Mirëpo megjithatë, një pjesë e mirë e shqiptarëve aty që nuk bëjnë në kategorinë e udhëheqësve, që ishin të ashpër shumë, ishin edhe kategorikë. Organizatorja me gjithë një profesor që kam respekt për te, Emin Fejzën, ishim organizatore të lëvizjes studentore edhe fëmijëve në Vushtrri. Edhe shkoi ajo, pasoi ajo, isha zëvendës drejtoreshe, shkoi me përjashtim nga vendi i punës, meta deri në '86-tën pa vend t'punës. Po nuk m'tronditi fort, osht' interesant se e prisja se e ban një vepër e din që ki pasoja. Për mu ishte jo pushim, po vazhdova studimet se atëhere ishte me shkollë të lartë pedagogjike e kisha kry ktu n'Prishtinë, vazhdova fakultetin, Letërsi, Gjuhë në Fakultetin Filozofik.

Dhe çka thonin kto, rahat s'ishin serbët, thojshin "Kjo leje që u përjashtu, po kjo po studion". Që edhe atë drejtë me ta mohu mos me studiu. Vazhdova edhe ate edhe në '86-tën, ishim të detyrum shumë, shumë kishim presione, ishim të detyrum, vajza ishte, Xheri ishte e fejume. Tendencat ishin që ne të ikim prej një rrethi të ngushtë, ishte vërtetë për veprimtarinë tonë rreth i ngushtë, dhe kalum në Prishtinë. E unë pranohej në shkollën fillore Dardania për një mujë ditë. Aty, t'them jo aftësitë po megjithatë me veprimtarinë time une nuk mposhtja që m'largun tri-katër vjet prej pune. Vazhdova me po të njejtin avaz, po të njejtën gjë dhe fitova venin e përhershëm aty (buzëqeshë). E dini trazirat që jon ba ma tutje, mas '81-shit erdh '89-shi ku minatorët u futën zgafellë e ishte një akt i shkëlqyer që mund të bëjë një xehtar për çështjen edhe atë çka do ta prite prej '81-shit Kosovën në të ardhmen.

Ajo ngjarje ka metë në historinë e çlirimit të Kosovës, domethanë kur minatorët u futën në zgafellë si protestë e politikës të dhunshme të Serbisë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Dhe, organizova ishte kur ata rrinin në zgafellë pa ushqim, pa dritë, pa ajr sa duhet, duhet edhe na të solidarizohemi dhe organizova 24 orë të rrëmë pa ngrënë në shkollë. Ishin dakord të tërë shqiptarët, po aty ishin edhe serbët dhe ata rrijshin anash, po me mllef shiqojshin se çka po ndodhë. E organizum, isha iniciatore unë dhe sekretaria m'ka nihmu shumë, e shkollës që fatkeqësisht s'po m'kujtohet emri. Ka qenë një gru e mirë shumë, punëtore e mirë dhe përpilova edhe telegram që u qu... hala egziston te televizioni jonë në '91-shin, ekzistonte dhe quante telegram Radios, Radio Prishtinës. Dhe këtë aktivitet natyrisht që i ra në sy Komitetit Komunal të Prishtinës dhe fillun peripecitë e ndryshme rreth përjashtimit të këtij kuadri që ka luftu për çështjen tonë, që janë solidarzu me minatorët.

Përveç asaj, kam organizu ndihma për fëmijët e minatorëve që ishin n'zgafellë, fëmijët që ishin lanë jashtë domethanë familjet pa të ardhuna. Ka qenë ajo 8 Marsi ku janë mledhë, kanë propozu... kërkush asnjë fëmijë s'guxon sot t'i qoj msusës karafil ose si zakonisht dhurata që kanë qenë modeste. Ato pare duhet t'i shkojnë fëmijëve të minatorëve edhe u destinu që fëmijëve të minatorëve t'ju qojmë atë dhuratë. Domethanë ndihmë ishte, ndihmë simbolike të thuash por që jemi me ta. Në '89-shin, një ditë kisha edhe nanën, kishte ardhë me m'vizitu prej Ulqinit dhe e dinte kto problemet që po m'përcjellin dhe shkoja n'shollë. Te dera e shkollës m'priti drejtori dhunshëm tha, "Nuk guxon me hy n'shollë". Thash, "M'lejo, sot ta dorëzoi ditarin". Tha, "Jashtë, s'ke t'drejtë", ishte drejtorja e dhunshme. Mos t'ja përmën emnat atyne, se ata ishin n'shërbim të pushtetit që ushtronte dhunë ndaj shumicës shqiptare edhe arsimit shqip. Dhe tha, "Mundesh me liru menjihere ndërtesën e shkollës, munesh me e liru shkollën". M'përcjellin dy arsimtarë që e kishin kry turnin paradite, unë shkoja masdite me klasët e pesë-ta, me t'pesë-tat, gjashtë-tat nuk e kam ashtu. Dhe u ktheva ballëhapun e tha, "E çuditshme është..." drejtora, dy vllazën janë gjeografë, thash, "E çuditshme..." m'duket vllau, Azemi, "E çuditshme", tha, "nuk m'ërzitem". Thash "Pse t'mërzitem, mos bana naj gjë t'keqe që m'përjashtun? Do t'mërzitem prej... nëse kam punu diçka të pahijshme ndaj popullit tem, ndaj njeriut. Nuk po mërzitna fare". Si e hapa derën, nana prej qoshës, "A

t'hedhën a?" (qeshë). Thash, "Po, nanë. M'hedhën edhe pesë pare s'po i jap<sup>3</sup> që m'hedhën. E di që diçka jam t'u lëvizë për çështjen tonë."

Nejse kjo ishte '89-shi dhe u kfillën edhe institucionet tona edhe pozitën ata që merrshin që ishin n'krye, ata veç fillun... se diçka e tmerrshme po ngjan në Kosovë, lëvizi krejt popullata e Kosovës dhe m'thojnë t'ankohesh patjetër. Zeqeria Cana erdh, se ishte në Kshillin për të Drejtat e Njeriut, mori të gjitha ato të dhënat edhe çka policia ka ba kur kanë dalë n'demonstrata për t'u kthy n'punë. Policia e ka maltretu Mimosën e pat promovimin e fondit që e pat çiftit Buçinca deklaroi në atë dokumentarin, tha, "Na dolëm, t'na i kthejnë arsimtarët në shkollë". Dhe policia ç'bëri? E ka maltretu Mimosën. Ajo një mujë ditë ka qenë në kurim. Domethanë kanë ushtru dhunë fizike mi nxanësit.

Pastaj ndodhi ajo që unë veç e kisha plotsu kushtin për penzionim, por para penzionimit nuk do të dal tash në penzionim edhe shkoi çështja n'gjykatë. Dy gjykatës të shkëlqyer e kryejnë detyrën e vetë edhe ajo është detyrë, detyrë patriotike. Për tre muaj më kthyen në procesin mësimor, dhe çka ngjan? Tha, "Ke lejen të shkosh, sot ti duhesh me fillu me punu. Ke fitu prej gjykatës, ke fitu procesin gjyqësor". Dhe shkoj afrohem aty të dhunshmet ishin akoma aty. Njeni prej tyne m'zavendsonte mesa e tij, domethanë vajza e motrës. Edhe kish marrë ditarin n'dorë bash n'atë klasë ku unë jepsha msim se mu m'zavendsoi, orët e mija. Thash, "A ka mundësi t'ma jepësh atë ditar?" Tha, "T'lutem a ka mundësi edhe sot të jap msim?" Thash, "Asni mundësi s'ka, as sot, jashtë {drejton gishtin nga dera} prej ktu. Ditari është i jemi". Atë që e bani daja i saj, bana une me te. M'erdh keq po ajo s'kryeni detyrën e vetë, se nuk ish dashtë t'a pranoi detyrën kur përjashtohet një për çështje kombëtare apo çështjen tonë shqiptare. Prandaj i thash, "Jo! Munesh me nejtë kudo nëpër korridor, po n'klase s'ki me hy se kto janë orët e mija". Mora ditarin dhe u futa, gzimi i fëmijëve që u sjella mas tre muajve në procesin mësimor dhe dola atëherë se isha 38 vjet shërbim, domethanë 55 vjet i kisha kry se me 55 vjet dilsha në penzion dhe në '91-shin unë dola në penzion.

Mirëpo, megjithatë isha e lidhur me çështjen e shkollës dhe kur planprogramet donin të aplikonin në shkollën ku jepsha msim, edhe pse kisha dalë veç në penzion. Ishte një tubim kundër planprogrameve që u aplikonte pushteti i Millosheviçit. Dhe tash dikush duhet të flasë, duhet me folë para të gjithëve, para prindëve, para nxanësve... u mbyllte shkolla me fjalë të tjera. Një pjesë e objektit veç u nda, u nda për 500 nxanës që ishte dy e treta e ndërtesës, për dy mijë nxanës ishte një e katë ka e objektit. Edhe aty e mora fjalën, meqë ata që e udhëheqin nuk kishin guxim t'a merrnin fjalën. Prezent ishte profesori Pajazit Nushi një akademik dhe m'dëgjonte prej s'largut kur flisja me mllef me emocione shumë. Sikur i dhash fund procesit mësimor po kurrë pa u nda prej tij, dhe dola në penzion në '91-tën.

Ishte një gëzim i madh se nipin e tretë e fitova, Lurnin. Prej aty kam shku në maternitetin e Gllogovcit. Kur e kom pa në çfarë gjendje ishte materniteti, organizova ndihma për papuçat e lehonave, për sigurimin e kmishave t'natës edhe për sigurimin e... as çarshaf nuk kishte, mundeni me marrë me mend. Edhe ato nëpërmes ndihmave të qytetarëve, gjithmonë kam ditë me i shfrytëzu donatorët në dorë, edhe pse ishin të vegjël po megjithatë ekzistonin. Dhe, në atë moment kur kam vizitu nipin tem në Gllogovc, Drenas tash quhet, gjithashtu i kam qu kto ndihma dhe i jam drejtu doktorit të nderuar që jam shumë falemnderuese Selim Krasniqit, gjinekologut. Ai ka pas gjinekologjinë patologjike, ka pas një rast me Xherin, që t'thom ai është një prej një rastit që nuk mund t'a përmend, i ka nihmu shumë Xherit në lindje, në lindjen e Ledrit. Dhe ai, kur i'a kom dorëzu gjithë ato ndihma, asht' mahnitë me veprimin. Jo që e bana unë për nipin tim, se nipi dilte jo që ishte lindja e tij, por pash rastet që vizitova nipin, lindjen e tij, pash se në çfarë gjendje

<sup>3</sup> Shprehje e popullit për të thënë që nuk çaj kokën.

ishte materniteti në Gllogovc. Të gjithë shtatzanat e reja, ma nuk kishin guxim me shku në spitalin qendror tonin, maternitetin kryesor në Prishtinë, po u lindshin nëpër maternitete lokale, sepse drojshin se çdo gjë mund të ndodhë. Edhe mjekët ishin që kishin harru betimin e Hipokratit, ushtronte dhunë, ose dyshohej që lindjet nuk do të përfundonin ashtu siç duhet. Pra, kshtu ngjau edhe me nusen teme Suzanën, është një oftamologe, specialiste e mirë, e du shumë (buzëqeshë). Kur u lind i dyti, është edhe vajza e Hajredin Ukellit që kam pas respekt për te, ka qenë ekspert i mjeksisë. U lind... aty pash mjerimin e maternitetit, prandej pasoi pas kësaj se ne morëm djalin...

I gjithë ky aktivitet që unë e quaja ma tepër patriotik sesa politik, megjithatë merr ato përmasat, niancat [nuancat] e politikës, mirëpo, një politikë që shkon në favor të komunitetit tem, në favor të Kosovës, në favor të shqiptarëve... atë që e përjetojshin çdo ditë. Dhe, me një grup grash nga shkolla ku punoja u regjistruam në Lidhjen Demokratike të Kosovës, na priti profesor i ndjerë Fehmi Agani. Kjo për mu nuk ishte najfar partie, por ishte një lëvizje popullore ngaqë ishte partia e parë e regjistruar, që hala ekzistonte. Ishin momentet e fundit të shkatërrimit të Jugosllavisë, u regjistru Lidhja Demokratike e Kosovës, ju thashë edhe më parë që kjo për mu ishte një lëvizje popullore, komplet një lëvizje popullore. Aty, n'bazë të aktivitetit tim që ishte i dukshëm aty ku m'njihnin, shkolla, rezistenca, largimi prej pune, të gjitha kto banë që unë të jem akoma aktive dhe të futem tash në... mos t'a them se nuk e kam thanë kurrë... të futem në politikë. Megjithatë, krahas dhunës që u bante, kjo ishte një politikë me një program të caktuar, që ishte një program, nuk ishte me dhunë. Ju e dini që presidenti i parë Ibrahim Rugova, i cili ish, e quanim paqësor e vazhdojmë me atë kurs paqësor. Pastaj vazhdun edhe përpjekjet tjera, ishte dashtë një lëvizje ma e fortë me shku. U kriju Ushtria Çlirimtare e Kosovës që i dha hov gjithë kësaj lëvizjes tonë dhe vulosi, me fjalë të tjera, me ndihmën e ndërkombëtarëve, vulosi fatin e Kosovës kështu që e kemi sot.

Punova pa kursim në formimin e grusë. Kishim kryetare, megjithatë kryetari mungonte për një udhëtim post-diplomik në Gjermani dhe si nënkryetar udhëheqja Forumin e Grave të Lidhjes..deri '97-shën, dhe aty përfundova jetë time sa i përket, se e quaj unë "politike," ajo patriotike akoma vazhdon. Kshtu që, erdh një ide në '93-shin nga vizitat e ndryshme duhet të them prej organizatave të grave botnore, amerikane, evropiane thonte që veç Forumi gratë veç në Forum duhet... se ajo megjithatë nën tutelën e partisë. A duhet edhe një organizatë tjetër? Ishte "Motrat Qiriazit", ishte "Nënë Tereza" dhe vetëm këto dy organizata, njëna kishte humanizëm shumë, "Motrat Qiriazit" për arsimimin e fokusime. Dhe mu m'lindë një ide thom "A mund të bëjmë na diçka? Edhe një organizatë që merret veç me çështjen e grusë?" Dhe kujtova që të gjithë institucionet ishin shkatërru si institucionet arsimore, edhe të kulturës e artit, t'shkatërrime dhe unë bashkë me Shukrije Gashin dhe Xheraldinën-Xherin, vendosëm që t'krijojmë këtë asociacion.

Po ishte një ide që i'a prezentova edhe Shukit edhe Xherit, ishin n'pajtim shumë edhe m'ndihmun shumë në formimin e kësaj shoqate që u qujtë "Grupi i krijueseve dhe veterane të arsimit". Kishin programet e veta ku programi kryesor i krijueseve ishte arti, kurse veteraneve të arsimit ishte arsimit. Ishte një kombinim i shkëlqyeshëm se të dy këto asociacione, sistemi, ishin të shkatërruara dhe janë afër njana-tjetrës, pa arsimim nuk kemi as kulturën. Kshtu që kishim programet e caktuar, dhe ne le që veprum në të gjitha komunat e Kosovës, po fillim edhe tokat etnike që ishin jashtë shtetit amë {numron në gishta} Ulqini, Shkupi domethënë Maqedonia, Presheva, e dini që akoma është nën kthetrat e Serbisë, jom shumë e ashpër kur ju thom kthetra. E të gjitha kto pjesë etnike... dhe lidhshim një, mbajshim një kontakt, nëse s'mundnim fizik e mbajshim shpirtëror, lëvizshim diçka dhe patëm shumë suksese. Afër 120 veprimtari, ekspozita, koncerte të ndryshme në të gjitha këto vende ne i shfaqnim dhe i punum.

Kshtu që "Grupi i krijueseve dhe veteraneve të arsimit" banin në atë kohë një punë të shkëlqyer sepse i mlodhi të gjithë ato krijuese në një vend dhe ato pastaj me veprimtarinë e veta jepshin rezultate të

ndryshme në picture, në poezi dhe në muzikë. Kishim kompozitorë si Pranvera Badivukun, kishim piktores edhe Miradije Ramiqin edhe poete, kishim poete Shukrije Gashi bashkë me Xheraldinën dhe veteranet e arsimit me Veronika Mjedën me Vera Dinon me Fakete Kusari që m'ka përcjellë deri në 2006-tën, kam pas Faketen dorë të djalhtë për arsimimin e femrës shqiptare. Kjo ishte atëhere kalimi i jetës teme prej asaj politike kryesisht si gjuhë politike në atë të shoqërisë civile. Kjo ishte një organizatë jo-qeveritare. Mirëpo, s'pushoi puna jonë se qëllimi jonë ishte çlirimi nga kthetrat e ashpra të Millosheviçit dhe dhunën që ushtronte mbi popullatën shqiptare.

Megjithatë, ju tash që të gjitha kto 15 gra ishim aty, e bam gjithë këtë veprimtari lidhim, jo fizikisht por shpirtnisht lidhim të gjitha kto toka sikur menonim në qenien tone, bashkum të gjitha tokat shqiptare në një vend. Ishim edhe n'Shqipëri, Shqipëria noshta nuk kish problemet tona, se kto ishin tokat shqiptare mrena ish-Jugosllavisë. Dhe problemi i grusë shqiptare ishte krejt i natyrës tjetër, e problemi i grusë në Kosovë edhe në tokat e tjera etnike të shpërndara ishte krejt problem tjetër sepse na përjetojmë... ato t'paktën ishin t'lira në atdheun e vetë. Ata kishin problem krejt sociale të shlirimit të grusë, megjithatë ata e kanë pas ma lehtë, edhe e kanë ma lehtë se sa ne e kemi sot. Se t'shlirum jemi, një shtet shumë i ri, por që po shkon me hapa... duhet të shkojmë në hapa t'sigurtë, do t'i vërtetojmë ato hapa t'sigurtë me politikën që do t'bajmë me kto që i kemi në vendimarrje. Besoj që nuk duhet t'a hupim besimin tonë për atë çka kena punu. Nuk duhet të futem në analiza politike se nuk m'pëlqen ta bëjë ate, mirëpo çdo gja e shiqoj me një sy kritik, sa mund të reagoj ajo është... reagoj aty ku e kam rrethin tem. Në suazat e veprimtarisë teme, fokusi që jam fokusu në arsimim, aty, ajo ish ajo politika jeme, që duhet të baj për arsimimin dhe avansimin e pozitës së grusë.

Kshtu që, domethanë ajo ana politike, kryesisht politike nëse merret u braktis, po nuk u braktis puna në këtë asociacion si organizatë jo-qeveritare sepse na vazhdum çështjen e avansimit të grus, të pozitës së grus edhe shlirimin e saj nga prangat e mentalitetit patriarkal po edhe prangat e rezhimit të ashpër të Millosheviçit. Se kur i diskutojmë në Forum, kisha vrejtë edhe faktorin tonë mashkull, kisha vrejtë... "Tash na s'kemi kohë të mendojmë për pozitën e grus, kshtu diçka, se kemi synimin kombëtar". Po na paralel punojshim për çlirimin kombëtar domethënë një forcë ishim për t'u realizu të gjitha qëllimet që i kishim si mashkuj si femrat, sepse e tregum edhe me prezencën e grave tona vetëm në luftë për çlirim në UÇK. Domethanë që i tregum që na jemi t'zojat t'kapim edhe pushkët. Por ne praktikisht punojshim me këtë laps, domethënë me laps e kishte edhe slloganin, kjo sllogani i "Motrave Qiriazit", "Me laps në Evropë".

E ktu e kishim hallin, me atë laps, ta çlirojmë nga prangat shekullore grunë, se ishte një avansim, e përgatite Kosovën të pavarun me një barazi, ose me një arsimim të lartë të femrës, me një çlirim të hapt të femrës për të kapë hapin për Evropë se na i kemi taku Evropës, po fatkeqësia ka qenë ballkanike, historikisht ballkanike. Prandaj, m'u duk absurd kur njeni prej tyne që osht', ishte hala deputet, nuk duhet të i'a përmen emnin po m'u duk shumë konservator, m'u duk e papranushme që sot t'a kemi kohën për shlirimin e Kosovës... "Leje punën e grave", se puna e grave, ish puna e grave, merre me mend. Po s'u çudita fort se edhe ai ish i edukum në një familje patriarkale dhe se mendonte që ashtu duhet të arrijë në Evropë. Por shifet që me këtë barazi gjinore, veç jo që e kemi tepru, nuk e kemi tepru fare kur flasim e bisedojmë, por që osht' bo modë tash edhe mashkujt të thonë, "Po edhe na jemi për barazi gjinore". Kur futen n'shpi gruja ish gru, burri ish burrë prapë brenda shpisë. Flasim atë që duhet me folë e nuk bajmë atë që duhet me ba për çështjen e barazisë gjinore.

Kshtu që jeta jeme tash fillon në organizatë jo-qeveritare që m'flen shumë sepse edhe moshën e kisha, kurrë nuk kam dashtë të merrem me politikë. As s'më lejonte moshja, por as vetë nuk kam dashtë të merrem, të futem si aktive e që unë i baj apel grave tona të shkolluara, të mençura, që mos të largohen.

Noshta fillojmë me një organizatë jo-qeveritare, por kadalë, hap pas hapi kjo mundet me qenë një trampolinë për t'u marrë edhe me politikë sepse kur i'a thash presidentit, se u gzova që një presidente ma dha medaljen presidenciale për merita, u gzova që ishte dora e një gruje që ma dha dhe që e thash që na do t'i pushtojmë, noshta osht' e vrazhdë "pushtim" por as nuk mund t'i thom "grabisim". Në vetëdije me forcën tonë do t'i marrim të gjitha ato vende, edhe vendet vendimmarrëse. Edhe të gjitha do t'i kaplojmë, të gjitha institucionet, po kjo asht' ajo që e kërkon sot Kosova, e kërkon Evropën, jo për Evropën nuk e bajmë por ne na nevojitet që kjo grue të jetë, duhet të shkojë me hapa përpara paralel me mashkujt.

Kryesisht, nuk u kry puna jeme. Me kte t'them mas ate që i ngjau Kosovës, që u prite t'i ngjante Kosovës në '98-shin, '99-shin, ngjau! Nuk ishte e papritur, se u kapllu krejt Jugosllavia. Filloi shkatërrimi i ish-Jugosllavisë së Tito-s filloi me Kosovën e do të mbaroj me Kosovën, ashtu edhe ngjau. Çka na tash si grup, a duhet të merremi tash me ekspozita? Me çka? Ne u fokusum, sidomos "Grupi i veteranëve të arsimit" në strehimin e refugjatëve, fillon në '98-shin, fillon Drenica të sulmohet keqaz, Peja po ashtu rrethina. Në '98-shin, edhe ashtu çdo vit shkoja në Ulqin, tre muj në '98-shin bashkë me një gru t'madhe... t'them e madhe ishte ajo gru, po që isha iniciatore për formimin e shoqatës "Anima" në Ulqin, doktoresha- gjinekologe Zylfije Gjoni Duraku që bani shumë në strehimin e familjeve nga Drenica, nga rrethi i Pejës. I strehum tre mujë rresht familjet që kishin kryefamiljarin, ishin gratë, sepse ose burrat ishin në front, ose ishin dikun të ikur. Kshtu që, kur shifshim familjarët me kryefamiljarë mashkull nuk e strehojshim ate. Detyra jonë ishte gratë dhe fëmijët.

Bamë një punë t'madhe duke i'u falenderu shoqatës "Anima" po bashkë me shoqatën "Anima" ishte edhe profesoresha Mejreme, ajo uqlinake me origjinë, të trijat na ishim ulqinake, bashkë me Fahriun që na ka nihmu. Ka qenë gjithmonë n'dispozicion me veturën tonë të punojë në strehimin e këtyre fëmijëve dhe grave se i kishim gratë shtatzanë, në maternitet atje e ka lujte rolin gjinekologja jonë Zylfije Gjoni. Dhe n'fund morëm vendim se isha edhe në Kosovë që vikendicat se Shtoj ka shumë vikendica ku pronarë janë kosovarët me një urdhër të prerë s'ki ka e kam marrë atë guxim (buzëqeshë) po thash, "Ne kemi ardhë ktu..." të gjithë pushojshin a! Atje u kallke Kosova, Drenica, në '98-shin u kallke, Peja sidomos, rrethina e Pejës, Gjakova. Thash, "Ne kemi ardhë ktu n'pushim, të gjithë me m'i dorëzu çelësat e vikendicave, sot me komision", dhe të gjithë vikendicat janë dorëzu prej banorëve të Kosovës, i janë lshu refugjatëve të Drenicës. Janë vendosë në të gjitha vikendicat tona.

Shembulli i parë ishte i jemi, e kam pas një familje prej Komoranit dhe vikendica jeme osht' e vogël, modeste shumë me dy dhoma, megjithatë u strehu një familje e gjërë aty edhe të gjithë të tjerët. Muharrem Gashi, Emine Gashi, gjinekologe, Talat Gjinollit komplet ksaj klipës, Agronit... të gjithë kta ma mos t'i përmen të gjithë ata që ishin jashtë... ishin bregut të detit, po mrapa, Shtoji i Poshtëm po edhe Shtoji i Lartë. Dhe kshtu të gjitha kto familje u strehun dhe gjetëm donatorë të jashtëm që diktonin që do gra po punonin në strehimin e kosovarëve. Kshtu thojshin, as Drenicë... po kosovarëve. Mledhëm t'holla që i kemi t'shënume se ku janë dhanë, çka asht' dhanë. Logjistikën e mante gjithmonë Fahriu, dhe arrinte me t'vërtetë me zbutë dhe m'i dhanë krahë atyne familjeve t'u ju qenë pranë. Pastaj erdh koha që edhe na u deshtë, nuk mrrijta me shku n'Ulqin o familjen u dëbum dhe shkum në Strugë.

Si e kam thanë edhe ma parë, unë jam përqendru kryesisht në arsimimin dhe edukimin e vajzave në pjesët rurale. Nuk ka qenë lehtë as para luftës, tani edhe pas luftës veprimet që i kena ba si ekipë, se kam bashkëpunu me një kolegen teme veterane atëhere të arsimit, Fakete Kursani e cila hap pas hapi m'ka përcjellë tan kohën. Por kryesisht mbshtetjen e kemi pas edhe prej Fahriut bashkëshortit tim, kshtu që nuk ka qenë as e lehtë po ka qenë knaqësi për ne që t'kontaktojmë direkt me personat që mentalisht janë largu prej shkollimit të tyre. Natyrisht që është dashtë të marrim listë për braktisjen, e kte e kemi

marrë në seksionin e arsimit ku janë evidentu me gjithë që kemi marrë një listë prej 200 e sa nxënësve, tetëet, 20 përqind e kishin braktisë vajzat, ne megjithatë n'terren gjetëm një numër shumë ma të madh të braktisjes së vajzave në shkollë.

Faza e parë ose hapi i parë ishte të kontaktojmë me familjarët, dhe puna jonë ishte në këmbë prej shtëpisë në shtëpisë. Dhe u përqendrojmë në një fshat dhe aty e kontaktojmë me përfaqësues të fshatit dhe pastaj merrshim udhëzimet ku gjinden shpitë, ku gjinden lagjet e ndryshme, ku mendojmë që aty duhet me pas mjaft vajza që e kanë braktisë shkollën. Puna jonë ju thashë, hapi i parë ishte të kontaktojmë me familjarët. Ish një çudi e madhe se kur kontaktojmë me familjarët, na pritshin shumë mirë ngaqë n'atë terren ku ne shkonim për t'i përvetësuar mendimin edhe t'prindëve edhe t'vajzave, ishte diçka që m'ka knaqë sepse kryefamiljari kryesisht ishte për braktisje. Kurse bashkëshortja e tij, nana e vajzës me gjeste tregojshin që ky është ky që nuk lejon, ato ishin pro. Kishte edhe të tilla që i konvenonte vajza të rrijë në shtëpi, mirëpo kryesisht 80 përqind të nanave ishin për shkollimin e... Sepse e matnin jetën e saj që ka shku pa shkollim, e atje nuk i'a dëshironte fëmijë së vetë- vajzës.

Dhe prej dere n'derë që vizitonim shtëpiat kemi pas dhe reagime, rezistencë, mirëpo para lufte i kemi motivu kryefamiljarët me një rast se ne ishim... para, para lufte ishim të okupum. Rezimi i Millosheviçit ishte aq i ashpër dhe fokusi i Millosheviçit ishte mbyllja e shkollave. Domethanë, aty ishin dy faktorët kryesorë, mosarsimimi po me planeprogramet e Millosheviçit ish gjenocidi kulturor-arsimor në popullatën shqiptare. Nuk donin me qu vajzën në shkollë, taman, thash, "Ju jeni në programin e veprimt të Millosheviçit që ushtron në Kosovë. Ai na i mbylli shkollat, se e kishin të njohur dhe ti po i nihmon me mosvijimin e vajzës në shkollë". "Jo" thotë, "unë nuk jom në programin e Millosheviçit, unë jom kundër. Unë e du Kosovën e lirë, une du m'u çliru prej ktij rezimi të egër". "Atëherë" thashë "ti me një fjalë po i ndihmon". Dhe duke bisedu (buzëqeshë) edhe duke... natyrisht që na kishim shumë kujdes, takt se si do të bisedonim me te. Edhe n'fund bim n'përfundim se, "Nëse është ndihmesë lejimi i vajzës teme me shku n'skollë, ndihmesë për çështjen tonë, për lirinë e Kosovës, ja ku e keni merreni vajzën". (Buzëqeshë) Domethanë u thente me çekiç aty pak, kishte mentalitet jo pak, po mjaft mentalitet patriarkal që vajza nuk duhet të shkollohet, po i shtonte edhe post-bloqet, pasiguria, ato lëvizshin në pasiguri.

Megjithatë, na i sigurojmë se kto vajza do t'i përcjellim tan kohën e shkollimit të tyre, prandaj e mira është që ne t'merremi vesh që kto vajza të vazhdojnë shkollimin, edhe pse provimet kaluse kishin kalu. Kishin kalu si zakonisht që duhet me hy në provim pranues për me hy në klasën e parë të gjimnazit. Ne kemi pas mirëkuptim të drejtoritë e shkollave të mesme ku në një rast i kemi qu 37 vajza dhe ka qenë koha, fundi i tetorit. Dhe me mirëkuptim t'madh se çka ne jemi t'u punu, ata i pranun vajzat dhe ato vajza janë shpërnda. Kanë kry shkollat e mesme dhe 22 prej tyre janë siguru në universitet dhe kemi siguru bursa për ato vajza prej donatorëve vendorë. Të gjitha kto vajza që i nxitshim, fuqizojshim për çështjen e shkollimit të mesëm, ne i sigurojmë prej donatorëve vendorë. Galica Tours ishte atëherë para lufte edhe Saraçi Tours, jepnin një librezë me një fotografi t'vogël vajzës dhe e nënshkrume prej grupit t'veteranëve të arsimit edhe kur vajza tregonte librezën, s'kishte nevojë të pagunte as pesëesunte cent sa ishte atëhere, ishin dinarët atëhere në qarkullim.

Kshtu që, ndihmum afër 92 vajza brenda një viti, 92 vajza i futëm n'skollë, se kishte braktisje edhe n'skollimin fillor dhe shkollimin e mesëm në komunën e Vushtrisë. Këtë gjë e kena ba në 67 fshatëra të komunës së Vushtrisë. Ishte kohë e vështirë sepse bisedonim me familjarët, kryefamiljarët, kryesisht kryefamiljar ishte mashkulli. Pastaj, anash bisedojshim dhe i bindshim vajzat sepse sinjalet inepte kryefamiljari që nuk ka shkollim, "nuk pajtohem". E dinte atmosferën sesi mbretonte për shkollimin e saj, ne i bindnim që ata duhet të luftojnë për jetën e vetë, jo t'u u konfrontu me prindë, po bisedat e

ndryshme, bindje që jeta e saj duhet të ndryshojë prej asaj që ka qenë e nanës t'vetë dhe gjeneratave t' tjera.

Kshtu që, kemi arritë që afër 910 vajza të shkollohen në shkollimin e mesëm dhe të vazhdojnë në universitet. Kjo ishte sa i përket arsimimit formal, aty na kishim akcente të arsimit formal. Arsimitimi jo-formal është zhdukja e analfabetizmit, kurset e ndryshme si... se patëm hapë edhe qendrën për arsimimin jo-formal ku u msonte gjuha angleze, u msonte rrobaqepsija dhe seksioni i shëndetësisë për shëndetin e vajzave t'reja dhe nanave t'reja. Kurset anglishte e mundësonin vajzën, nëse ka kry shkollën e mesme, e mundësonin që nesër pasnesër ajo t'gjejë një punë t'sigurtë se anglishtja ishte diçka si kusht i parë që mund të punësohet, edhe vajza me ardhë deri ke mjetet e veta personale materiale po me fitimin e atyne mjeteve, fitonte vajza nifar lirie. Nëse ajo ekonomikisht i fiton mjetet materiale, s'kishte nevojë dikush t'i nihte se ishte nifar mnyre, në nifar mnyre e fitonte nifar pavarësie megjithqë gjithmonë i përgjigjemi dikujt e sidomos kryefamiljarit, qoftë e fiton pare ose çfarëdo veprimi, gjithmonë i përgjigjemi kryefamiljarit.

Kshtu që, na afër 1800 vajza... kjo tash po flas për periodën mas çlirimit, mas çlirimit Kosova ishte e shkatërrume plotësisht, ekonomikisht e shkatërrume se jemi dëshmitarë e gjendjes së Kosovës mas çlirimit. Kishim problem se u ndrru... u banë ndryshime të ndryshme në reformë, tash ma nuk ishte tetë vjeçare po u donte nantë vjeçare. Ktu kishim problem shumë t'madh që vajzat i fusnim në klasën e nantë sepse u krijun qendrat, pikat e ndryshme ku n'terren ku vajzat duhet me dhanë. Vajza u donte me udhëtu, për atë udhëtim u donte një pagë, domethanë një euro u donte me dhanë vajza me shku edhe me ardhë. Fillun me braktisë shkollën, klasën e nantë. Kjo ishte një problem, momentalisht problem shumë serioz dhe na fillun fushatën për vetëdijsimin e vajzës që ajo patjetër duhet të vazhdojë, kudo që të jenë, duhet të vazhdojë shkollimin ma tutje. Domethanë, klasa e nantë u njihte nantë vjeçare atëhere dhe patëm shumë probleme po duke i'u falemnderu donatorëve vendorë ne prapë sigurum për ato vajza udhëtimin falas. (Buzëqeshë) Mirëpo ma vonë, fatbardhësisht ma vonë ajo çështje u rregullu...

Ishim atëherë kur vajzat e braktisin shkollën sepse u donte me udhëtu, u donte me udhëtu në fshat tjetër ose n'qendra. Kryesisht në qendrat, qendrat ishin në Vushtrri në qytetin e Vushtrrisë. Nëpër fshatëra nuk kishte klasa e nantë, mirëpo falë sistemit, falë edhe seksioneve të arsimit se tash ishim të lirë, u duhke me zbatu reformën që erdh. Domethanë, që një vajzë mund të numrohet shkollimi fillor deri në nantën klasë. Secila shkollë amë që kishte tetë klasë, u hap edhe klasa e nantë, kshtu që s'kishim problem fare aty. Domethanë që ky problem veç u kry. Tash kishim, problemi jonë tash ishte që kto vajza tash vazhdojnë shkollimin e mesëm. Megjithqë kemi pas probleme n'fillim që ato prapë t'vazhdojnë se ishte një pauzë ku kta nuk kishin shku në, kishin hup vitin në disa mujë, aty prapë jemi fokun dhe ato vajza që metën gjysë viti ose tre-katër mujë pa shku në klasën e nantë, megjithatë prapë na me mirëkuptim të seksionit të nantë për arsim ne i futëm ato vajza dhe vazhdun shkollimin nantë vjeçar, nuk ishte ma tetë vjeçar po nantë vjeçar. Tash ishte problemi se si do t'i qojmë të gjitha kto vajza në shkollimin e mesëm.

Duhet të them që në Vushtrri ekzistonte gjimnazi, shkolla teknike edhe shkolla profesionale dhe ne klasët e nanta shkonim para se e kryshin shkollën, klasën e nantë, bisedonim vetëm me vajza. E tash mundësitë e vajzave për shkollimin e mesëm. Gjenim në një klasë mund të ishin njëzet vajza, dhjetë vajza, 15 vajza... prej të gjitha atyne, kishte vajza që prej fillimit thotë, "Unë nuk kam mundësi me u shkollu sepse s'ka mjete materiale". Kishte vajza që edhe prindërit i kishin dakord, ishin dakord, mirëpo mundësitë materiale mungojshin. Dhe na tash u orientum ka sigurimi i kyne vajzave që mos ta braktisin shkollën nga sigurimi i mjeteve të ndryshme, aty kryesisht ishte transporti në pyetje.

Si thash ma parë edhe para lufte, t'njeitin donatorë vazhdun pas lufte kto vajza t'i shpërblejnë me një fjalë, ishte lloj shpërblimi prej donatorëve që falas të udhëtojnë për shkollimin e mesëm. Kemi pas shumë sukses, ma parë thash që kemi fut në shkollë 910 vajza. Kur ishte puna e arsimimit jo-formal afër 1800 vajza kalun nëpër qendrën për arsimimin jo-formal, u aftësun në gjuhën angleze, n'kompjuter dhe rrobaqepësi; bile në rrobaqepësi, ata... të gjithë i'u nënshtrun komisionit për aftësim. Mirëpo, na nuk kishim licencë që t'u japim diploma për kto vajza, por vërtetime gjithësesi jepshin. E me kto vërtetime ato vazhdojshin edhe fazën e dytë në anglisht, kompjuter dhe u pranonte ai kurs i anglishtës, i kompjuterit dhe rrobaqepësi, u pranonte që ma tutje të vazhdonin edhe vajzat e merrshin një lloj diplome. Shumë u patën përhapë andulimet, premja e flokëve e të gjitha këto, mirëpo une s'e kom praktiku fort. edhe pse kom pas ofrime, donacionesh, puna jeme ka qenë ose organizata jeme ka qenë e profilizume, s'kam pranuar asnjë donacion ku nuk futet në arsimin formal dhe jo-formal. Kshtu që pra edhe 1800 vajza kalojnë nëpër qendrën e përgjithshme të arsimimit jo-formal.

Konferenca Botnore në Pekin ishte në shtator dikun 1995, ku grupet e grave nga Amerika si një grup i grave "Star" u quante, "Star Project" bisedun me gratë që mirren me aktivitete, bisedun me gratë e Kosovës, ato që i takojshin kryesisht jo partive, po i takojshin shoqërisë civile. Ka qenë "Qendra e Gruas", ka qenë kjo "Star Project" që ekzistonte si njësi në Prishtinë, po edhe na si Forum i Grusë, n'bazë të Forumit të Grusë ku une e kam udhëheqë tri vjet Forumin e Grusë jam caktuar për me marrë pjesë në Konferencën Botnore të Grave në Pekin. Ne kemi qenë si kategori jo-qeveritare, shtatë-tetë gra kemi qenë, Forumin e Grusë e ka financuar Lidhja Demokratike, kurse kto grupet t' tjera i ka financuar shoqata ndërkombëtare të grave, kryesisht amerikanet.

Ne patëm rast me u taku të gjitha gratë e vendeve edhe në zhvillim edhe në tranzicion dhe vendeve që ishin të po asaj natyres edhe po asaj atmosfere politike siç mretnonte tek ne. Gjetëm shumë përkrahje, megjithatë ne ishim në pjesë jo-qeveritare, kurse në pjesën qeveritare, jo momentalisht po si delegacion ishte edhe Hilary Clinton. Mirëpo ne s'kemi mujtë me pas qasje n'atë konferencë sepse kemi qenë t'papranuar si shtet, tek n'formim e sipër që ka qenë iluzore ta mendojmë na që kishim fituar ashtu shpejt e shpejt shtetësinë ose shpëtimin prej Serbisë. Mirëpo, Sevdije Ahmeti ka qenë njëjta prej aktivisteve ku është sponzoruar prej amerikanëve dhe me një dokumentim të pasun se po ngjet me gratë dhe fmitë. Se ktu programi ishte rreth dhunës që ushtrohet, një pushtet i egër serb, dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, edhe ajo kishte një material të bollshëm dhe kishte kontakte me bashkëveprimtarët amerikanë që ishin të interesuar për çështjen e grusë dhe fëmijëve në Kosovë. Dhe nëpërmjet veprimtarëve dhe shoqëve të veta, ajo plasoi një material të bollshëm në pjesën zyrtare, oficiale të konferencës së grave të botës në Pekin.

Mirëpo, kjo pjesa jo-qeveritare, ajo u manta me *workshop*-e dhe kishte seksione të ndryshme dhe aty merrnin pjesë... ka qenë *workshop*-i i veçantë i Kosovës. Aty prezent i kena pas Edita Tahirin, kurse moderatore Sevdije Ahmetin. Ka folë Edita në atë *workshop*, ka folë edhe Edi Shukriu, mirëpo si duket ishte dashtë edhe nuk dinim si do të sillemi, ishte gja e re për ne (buzëqeshë). Ishte dashtë ma tepër të tregojmë ngjarje se çka ngjan me grunë e fëmijë në Kosovë, dhe sikur ma tha një Julia Mertos kur u kthym në Kosovë, tha, "Workshop-i juaj, sikur dështoi". Dhe unë me habi, "E pse?", tha, "Ishte dashtë disa gra të flasin, shumë gra të flasin". Me përjetimet e tyre se na kishim çdo ditë përjetime, si aktiviste kishim përjetime n'terren. Ishte dashtë të flisnin ma shumë ngjarjet konkrete se ç'ndodhë në Kosovë.

Kshtu që megjithatë zëri jonë u ndi në atë konferencë dhe konferenca zgjati ma tepër se një javë ditë. Vazhdoi puna jonë... kjo ishte mos t'them puna jonë politike, por kryesisht e fokusuar në pozitën e grusë n'Kosovë n'atë kohë ku grujat përjetonte dyfish dhunën sepse i'u vrite fëmija para syve t'saj, i'u vrisnin

burrat para syve t'saj. E dhuna ishte e papërshkrushme ate çka përjetoi gruaja gjatë rezhimit të Millosheviçit.

Dhe pas lufte natyrisht nuk pushum së punuari se kishte shumë nevojë mas shkatërrimit në Kosovë plotësisht ekonomik, ishte katastrof. Kshtu që, kishte nevojë shumë të vazhdoj punën me ato vajza që i futëm n'shollë, po ishte edhe fuqizimi i tyre që t'vazhdojnë mos t'mesin me një shkollë t'mesme, po synimi jonë ishte që ato vajza të studiojnë dhe të futen në universitete. Nuk ishte lehtë sepse simas ni sondazhi që e bamë në 2005-tën, organizata jonë na sponzoroi FDI [Foreign Direct Investment (Investim Direct i Huaj)] i Amerikës kuptum që ma nuk kishim fort problem me mentalitetin patriarkal. Na gzone fakti që veç kryefamiljarët kishin marrë vesh prej shkollimit, se shkollimi i vajzave ishte i domosdoshëm, mirëpo ishte ky fakti tjetër na doli numri n'sondazh në 50 e sa fshatëra që intervistum kryefamiljarët doli se tetëetoli stum përqind, osht' faktori ekonomik.

Na tash kishim një brengë akoma ma të madhe se si kto vajza do t'i stimulojmë si do të shkojmë te çështja ekonomike, ishte bazë për shkollim. Prapë na u sollën donatorët vendorë, i sigurum vajzave veshmbathje se dilnin t'shkatërrum familjet, sidomos fshatërat i kena pas t'shkatërrum plotësisht, me shtëpi, me pasuri me çka kanë pas, për tokë i kishin. Sigurum mjetet edhe t'transportit, sigurum veshmbathje, po edhe mjete mësimore, domethanë në kto u lshum në kto tri... do t'them se si do t'i sigurojmë prej donatorëve të gjithë kto arsye që kishin, vërtetë kishin arsye që vajzat nuk kanë mundësi të vazhdojë shkollimin megjithatë, (buzëqeshë) prapë arritëm. Mirëpo në familjet e ndryshme kur e shifnim që vajza mugon, se përcillshim permanent përcillshim, vijimin e saj në shkollimin e mesëm, po edhe vizitonim familjet pse ajo mungonte. I monitorojshim vajzat, ato që i futshim n'shollë tan kohën i monitorojshim edhe si shkon suksesi i tyre e të gjitha.

Kur e shifnim që disa vajza veç po mungojnë, me ditë t'tana po mungojnë, menihere n'adresën e caktume na shkojshim n'shtëpi dhe n'bisedë me prindë thotë, "Unë e kom një euro" t'thom tash "një lek, mirëpo une e kom djalin, përparësi ktu e kom djalin". Dhe shofim që abuzohet vajza megjithatë edhe pse menonte prindi, domethanë thash edhe ma parë që ra ai mentaliteti që ishte knaqësi për ne. Megjithatë, e ka një lek ai do të i'a jap djalit, e vajza prapë se prapë nuk do të... se e mendon që ajo vajzë, ardhmënia e asaj vajzës nuk osht' n'atë familje, se do të shkojë në familje tjetër do japë shtesë një familjes tjetër dhe nuk ka ma randsi se a do t'përkujdeset ai për te a jo. Kurse djali, ishte ai që sigurate kryefamiljarit nesër masnesër, n'moshë i sigurate mbijetesën e tij, edhe ishte një fakt ajo. Edhe aty ne reagum dhe i tham, "Nuk ka për vajzën, ne do t'i sigurojmë edhe veshmbathjen edhe transportin falas falë donatorëve vendorë".

Dhe ish çudi kjo puna e donatorëve vendorë sepse firma ne s'kemi pas, kompani nëpër Kosovë s'kemi pas, kanë qenë do kompani t'vogla megjithatë ashtu si ishin, ata ishin n'gjendje për çështjen e shkollimit të vajzave të shtrijnë dorën dhe të na sponzorojnë. Kjo m'ka shty pastaj, ky reagim i donatorëve se tash na bajegi n'këtë pesë vjetshin e fundit kemi zhvillim të disa kompanive, bile kompani shumë të mdha, me kompani me shumë përfitime. M'ka shti me menu pse t'gjithë kto donatorë veç e veç jepshin t'holla, pse nuk mund të krijohet një pikë qëndrim. Ai pikë qëndrim do t'jetë fondi edhe tan kohën si ide m'u ka sjellë t'u m'dhanë kurajo donatorëve n'dorë, t'u m'dhanë kurajo. Duhet të krijohet një fond për shkollimin e vajzave, të gjithë atyne vajzave, qofshin në fshat, se na u fokusum tan kohën fokusi jonë ka qenë n'fshat, sepse aty ka qenë nevoja ma e madhe dhe shkatërrimet e mdhaja kanë qenë, po kanë qenë edhe nëpër qytete. Mirëpo, edhe ajo vajza që gjendja ekonomike ka qenë mesatare, vajza megjithatë asht' abuzu, nuk ka shku n'shollë. E prej asaj kategorie t'vajzave ne duhet të krijohet si ide tan kohën duhet të krijohet ky fond. Ishin dakord edhe bashkëshorti jem, me ndihmën e tij kena ba n'terren me t'vërtetë çudi, sepse ky ka qenë gjithmonë i gatshëm të m'përkrahë. Sepse edhe ai ish marrë prej një profilit arsimor, është

pedagog me profesion. Mirëpo, që tan kohën procesi mësimor nuk ka.... se ka qenë kuadër i kërkum, dhe kam pas gjithënjë një mbështetjen e saj dhe besa edhe autoritetin e tij që e ka gzu n'atë trevë ku kena punu. Puna jonë nuk osht' shtri vetëm në komunën e Vushtrrisë, por në regjionin e Mitrovicës, ku n'regjionin e Mitrovicës i takon Mitrovica, Skenderaj edhe Vushtrria.

Një rast i veçantë është kur ne i kemi trajnimet shëndetësore të shëndetit elementar të grave dhe vajzave të reja, kena pas në Vllahi, osht' një fshat i Bajgorës aq i bukur, piktoresk, knaqësi është të vizitojsh ato vende atje aq të bukura. Nuk e kam pa Zvicrën, veç m'duket kto janë ma t'bukur se Zvicra, kto panorama që i kom pa n'Bajgorë, Vllahi. Dhe ne i ftonim gratë e reja dhe vajzat që nuk kanë arritë shkollimin e mesëm, t'i ftojme aty për arsimim jo-formal. Në ditën e parë, regjistrojmë nantë vajza e kanë kry klasën e tetë, klasën e nantë nuk shkojnë. U habitëm, listën e morëm, shkum se të gjitha i zhvillojshim nëpër shkolla ato kurset për shëndetin elementar të grusë dhe vajzave të reja. Trokisnim në derën e drejtorit, thash, "A keni dijeni që nëntë vajza tash ktu në Vllahi nuk vazhdojnë klasën e nantë?" Thotë, "Më falni unë..." bisedoi me mu, Faketen, na të tre hyjmë në zyre, tha, "E dijmë që nuk..." tha, "çka keni me ba?" "Duhet me shku për Mitrovicë thotë. Me udhëtu n'Mitrovicë". Asnjë mundësi ato vajza nuk kishin me shku n'Mitrovicë se ai që e njef terrenin e din se si mundet me shku n'Bajgorë dhe n'Vllahi. Dhe unë me Fahriun, Faketen, Fahriu kryesisht njëfte edhe ato të seksionit n'Mitrovicë edhe i'a spjeron problemin. Edhe menjherë, nuk e maj n'men se cili ishte ai që ishte përgjegjës për arsim, ndërmoi hapat e parë dhe merrni me mend, mas sa mujsh hapi, siguroi këtë personelin arsimor dhe hapi klasën e nantë. Ku kto t'klasëve t'teta që e krynin tashti ka qershori ishin edhe disa vajza, se u donte për me hapë paralele, u donte mas pakti 15 nxanës. Ato ishin veç nantë që kishin metë pa... Dhe hapet paralelja, në vitin vijues ato nantë vajza edhe pse e braktisin një vjet, vazhdun klasën e nantë, me fjalë të tjera ato nantë nuk metën pa shkollën nantë vjeçare. Dhe kur ta kryjnë shkollën kishte mundësi me u regjistru në shkollë t'mesme, se me tetë vjeçare nuk mund të regjistrohej në shkollën e mesme. Ky ishte një rast shumë i veçantë po që ne e realizum me sukses.

## Feminizmi

Është çuditërisht se çdo lëvizje e grusë, po flas për terrenin ku jetoj, në ambientin ku jetoj unë në Kosovë, çdo lëvizje e grusë se rebelim t'a them, kategoria e mashkujve thotë, "Ah feministe! Janë kërkesa të veçanta". Domethanë që edhe termini ose lëvizja feministe varet prej ambientit ku jeton, sepse t'u kryqëzohesh "feministe" se feministe kur kërkon të drejtat e barabarta. Unë mendoj që feminizmi duhet të ketë disa privilegje shtesë prej asaj të barazisë gjinore. Duhet t'i ketë, feminizmi tenton, ashtu e kuptoj unë! Edhe asht' e drejtë natyrale që duhet me pas, kjo lëvizje duhet me pas kërkesa të veçanta se pse asht' natyrë e veçantë se femra asht' riprodhuese. Asht' krijesë e shenjtë! Edhe nëse kërkohet ekstra të drejta, ka nga ato ekstra të drejta, ato kryqëzohen si feministe. Ktu ne për një lëvizje t'vogël, nëse kërkojmë t'drejtën me qenë e barabartë me mashkullin... "Ah ju feministet!", dhe me fjalë të tjera ish një atribut që e marrin shumë shtremtë, e shtremnun se lëvizja e feministeve edhe n'historikun e vetë ka qenë për barazinë gjinore.

Nëse në vendet ku sundon ligji edhe të drejtat, me ligj mbrohen të femnave, nëse kërkohet ma ekstra unë mund të them që osht' feminizëm. Ne dijmë Virgina Wolf "Një dhomë për vete", e kam lexu po edhe Taslima Nasrin n'ambientin që... kjo osht' aziatike Taslim Nasrin, kur i thotë "Gra zgjohuni!", domethanë jeni t'u fjetë për drejtat tuaja, nuk luftoni. Kurse Virgina Wolf e dini ishte angleze ku burri i vetë po edhe vjehrrin i vetë e kanë ndihmu për çështjen e barazisë gjinore, n'fund nuk arrin se e shenjume si feministe ekstreme, ajo edhe ban vetëvrasje kur nuk arrin asgja për luftën e saj, për arritjen e barazisë gjinore.

Ktu te na, kur don dikush me t'thanë që je t'u ba ekstra kërkesa, t'thotë feministe. Po mu s'më pengon ajo, le t'më thojnë feministe. Mirëpo n'Kosovë ne po luftojmë për barazi gjinore. Nuk jemi as kërkund. Ju lutem shkojmë bisedojmë, takime kemi, asht' fokus tash, edhe institucionet tona merren jo me ligje për barazi gjinore, të gjitha ato diskutohen, kur futet grua brenda në shtëpi, osht' po ajo që ka qenë para njëqind vjetëve, po ai mashkull që ish para njëqind vjetëve. Kërkush, asnjë t'drejtë nuk ta falë, por ne do të luftojmë që ta pushtojmë, por ta grabisim atë. Dhe mendoj nuk osht' fjalë e ashpër kur thom "ta grabisim" sepse me fuqinë tonë dhe energjinë tonë, ne luftojmë për barazi gjinore. Nuk menojmë që do t'shkojmë në një shoqni ku na do ta mposhtim mashkullin, ku do të i'a uzurpojmë të drejtat. Do të i'a uzurpojmë mashkullit të drejtat që na takojnë ne, na jemi për barazi, jemi shumë solidare bile, ishte dashtë shumë më tepër se aq me fitu ngaqë femna ish një qenie hyjnore. Ta them hyjnore se kam t'drejtë shumë që them hyjnore, sepse {numron në gishta} din me menaxhu një familje, din me falë, din me toleru, din me ruajtë familjen. Historikisht grua shqiptare n'Kosovë ka ruajtë familjen dhe gjithmonë ajo ka qenë e dyta e fundit për ta njoftë. Përveç kur fmija thotë, "Nanë!", nuk ka gja ma e bukur e ma e lartë thotë... Nanë. E këtë atribut s'e ka mashkulli, e m'vjen mirë që s'e ka.

Vetëveten, feministe... po në kto rrethana që janë ktu do ta konsideroja veten. Nuk du me luftu vetëm për barazi gjinore, t'tregoj anës t'mashkullit. Po nëse kta më mohohen dhe lufta jeme, do të luftojë për atë që më mohohet, le ta quajë veten edhe feministe. Le t'më qujnë edhe feministe. Po megjithatë, jam për një barazi gjinore për të drejtat e barabarta, sepse nuk mund të ekziston një shoqëri vetëm e femrave, nuk mund të ekzistojnë një shoqëri që po ekziston, në një botë që po ekziston... e mashkujve. Sepse mendoj, nuk duhet t'i fyejë mashkujt mirëpo, {numron në gishta} grua kurrë s'ka qenë për luftë, gjithmonë për paqe; grua kurrë s'ka qenë e organizume në krimin e organizum; grua kurrë nuk ka abuzu e s'ka ushtru dhunë. Të gjithë kto janë attribute që ne duhet t'i gzojmë sepse epiqendra e të gjitha t'kqijave që na ndodhin, m'falni, veç osht' mashkulli! {Numron në gjishta} Kush organizon prostitucionin? Kush me qenë një qenie njerëzore? Kush? Kush shfrytëzon prostitucionin? E shfrytëzon mashkulli. Domethanë të gjitha kto... epiqendra e t'kqijave që ekzistojnë, mos t'i gjeneralizoj në krejt kategoritë mashkullin, por lëvizja e të gjitha t'kqijave osht' mashkulli.

Me keqardhje thom që nuk osht'... janë të shkeluna t'drejtat ma elementare, mos t'flasin për kategorinë gru. Po, kur thojnë të drejtat e shkelura elementare njerëzore, nëse atë e bajnë institucionet. Se njeriu njeriun e shkel, i'a mohon të drejtën, mirëpo nëse institucionet nuk kanë kujdes, për çështjen e shkeljes së të drejtave njerëzore, atëhere ajo ish për brengosje. A unë mendoj që e brengosun jam për kto të drejta sepse mos t'tham që jom një kategori ka fundi, është limiti i jetës teme, është faza e tretë e jetës teme se nuk jetoj dy qind vjet, e as 150 vjet. Dhe mu e drejta me jetu m'është mohu, me jetu domethënë. M'është mohu që t'shfrytëzoj punën teme që kam ba si penzioniste, që m'vjen kaniher kur thom penzioniste, më vret shumë ajo fjalë. M'është mohu e drejta ma elementare me jetu, me gjallu. Mos t'flasim edhe për t'drejtat t'tjera dhe unë mendoj çdo njeri në Kosovë do t'i shfrytëzoj ato të drejta. Mirëpo, për me i shfrytëzu ato të drejta duhen ligjet.

Ne dijmë që edhe me kartën e Kombeve të Bashkume që s'guxon të cënohet e drejta personale e njeriut, ke na, cënohet edhe ajo. Sepse nuk m'varet vetëm nëse ti i sjellë ligjet, por nëse ato ligje nuk zbatohen, nuk mbështeten me fonde të ndryshme... Për shembull te barazia gjinore që tham, nëse ti ke sjellë ligjin për barazi gjinore, nëse ai ligj nuk mshtetet, mrapa nuk ka fondin për me i realizu, atëhere ai ligj metet i porealizum, domethanë nuk mund të zbatohet. E unë mendoj që shkelet e drejta, po kishte me qenë tragjike kur institucionet mund të shkelin të drejtat e njeriut. E besoj që ka jemi t'u shku, menoj që jemi t'u

u liru prej një sindrome që njeriu njeriut t'i baj dam, ose t'mos ketë kujdes për të drejtën personale, private, civile të vetë.

Kemi bile, fymje të randa nga një hoxhë që duhet injor,<sup>4</sup> deklarimi i tij duhet injor. Ajo ishte shkelje drastike e pritësisë sime, atë s'guxon simas Konventave, nuk guxon me ndodhë. E ku asht' ligji tashti? Se kur fyen një kategori që ajo kategori e ka bartë një njeri atë dhe ne vetëm mund të flasim që nuk thom mirë, mund ta injorojmë, mirëpo ai injorimi duhet... thotë njeri mas pari prej njësisë ka ka dalë, ku i përgjigjet atij. Ata duhet të reagojnë. E mendoj që për të drejtat e njeriut, e ndëgjova avokatin e popullit, tha, "Institucionet po i shkelin..." tha, sepse a i ka ato t'dhanat edhe ankesat që vijnë prej qytetarëve. Tha, "Institucionet tona po shkelin të drejtat elementare të njeriut, edhe për mos t'i shkelë ato duhet ligji, po ligji duhet të zbatohet, ligji duhet të funksionojë". Një shtet që nuk i funksionon ligji, nuk mund të shpresojë që munet shtet me qenë i mirëfilltë, po unë mendoj që kjo klasë politike që kemi sot, mendoj që osh t' u punu në atë drejtim. Të shohim sa do të arrijnë (buzëqeshë) atë synojnë me retorikë natyrisht. Çka do të zbatohet prej krejt asaj që flasim edhe veprojmë? Sepse veprimi është në kundërshtim me atë që kemi siguru me ligj.

Jo unë mendoj që jo, janë lanë anash kryesisht ato gra, aty-ktu merren me... ose janë shpërnda në shoqërinë civile, i takojnë shoqërisë civile, pak numrohen. Tash kohët e fundit, pasi kemi një presidente femër, unë besoj që do të ketë kujdes edhe ka kujdes për veprimtarët mos m'i harro. Se edhe të ktij llojit janë akoma t'u punu. Mirëpo, e di që një kujdes është tregu prej presidentes, sidomos te gratë që janë n'moshë e që kanë dhanë shumë për çështjen kombëtare. Në ditën e 8 Marsi-t unë kam fitu atë buxhetë lulësh që m'ka gzu shumë sepse edhe pse jam t'u vepru akoma, nuk jemi të harruara atyne t'90-ve, para njëzet vjete nuk jemi gra të harruara, sepse ato çdo ditë edhe ma tutje janë tu dëshmu në veprimet e tyre. Mirëpo në një kohë si mosha jeme, vjen që nesër-pasnesër, mund të... kam të drejtë në atë pushim, megjithëse unë mendoj kur unë nuk do të punoj, ose rrethi ku jetoj nuk do të mund të kontribuojë, të ndihmojë, m'duket sikur nuk jam gjallë, sikur nuk jetoj. Prandaj, gjithë kjo punë që bëj mu më jep satisfaksion që nihem e gjallë, nihem gjallë. Ato nuk ish vetëm fiziku të jetë gjallë, por shpirti të jetë, edhe vullneti të jetë atëherë nihem që vërtetë unë ala po jetokam.

Arritja jeme ma e madhe është ajo që kur unë i shof vajzat e mija, doktoresha, avokate, profesoresha të letërsisë, të gjitha kategoritë e univeristetit ishte dy që i kemi futë në Universitet është arritja ma e madhe n'jetë e jemja. Mirëpo, nuk knaqem me këtë arritje se ato veç kanë dalë n'dritë. Arritja jeme si punë permanente për shkollimin e vajzave është fondacioni për shkollimin e vajzave. Çifti Buçinca falë organizimit të shkëlqyer të një këshillit organizativ, duke marrë parasysh punën tonë që e kemi ba 50 vjeçare, si unë si bashkëshorti im- Fahriu, u promovu me 23 maj 2013-shin ku mrena dy orëve u arrit të tubohen 24 mijë euro. Ne bashkë me Fahriun, ne të dy do të shkojmë në një pushim të shkurtë, por kur kthehem prej pushimit, fillon puna jonë për lobimin me donatorë që ai fond, të funksionojë të paktën për pesë vite, ku donatorët do t'i derdhnin mjetet për shkollimin e vajzave. Shtatëdhjetë përqind të ktij fondi do të shkojnë në aty ku ka mbi fondi, ku lindë në Vushtrri. Po unë mendoj që do t'jetë kjo 2013-shi, ku shtatëdhjetë përqind të mjeteve të vajzave të komunës së Vushtrrisë, tridhjetë përqind do të dahet pastaj me rradhë në komunat tjera. Na menojmë që ma vonë, ky fond ishalla ka jetë t'gjatë, me mjete t'mjaftushme, do t'kalojë prej komune n'komunë, ku do të marrin... do t'kenë të drejtë ta gëzojnë këtë

<sup>4</sup> I referohet Shefqet Krasniqi, kleriku kryesor ose imami i xhamisë kryesore në Prishtinë i cili në vitin 2012 shfaqti haptazi pikëpamje radikale konservatore.

fond vajzat t'cilat i plotësojnë kriteret që do t'vrehen prej bordit t'fondacionit për shkollimin e vajzave "Çifti Buçinca". N'bazë të atyne kriterëve, kanë me fitu të drejtën për shkollim.

## Lufta

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për kohën e luftës.]*

**Naxhije Buçinca:** Unë mendoj që praktikisht, Kosova ishte në luftë sepse mbizotëronte policia e egër në Kosovë. Plus që edhe njësitë ushtarake, që ishte çudi e madhe, lëvizën në krejt Kosovën. Me dalje në sqenë [skenë] të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, na dha një shpresë se diçka do të lëvizë në Kosovë. Dhe me daljen e UÇK-së, aq ma tepër u egërsu dhuna ndaj popullatës civile në Kosovë. Filloi prej '98-shit, megjithëse tash krejt kjo pjesë deri të '98-shi që ishte një luftë si e mbyllun për faktorët ndërkombtarë, nuk ngjante asgja, me fjalë tjera. E Millosheviqi thonte, "Shkoni shiqoni, Kosova e qetë fare", e në të vërtetë çdo ditë ushtronte dhunë edhe fizike edhe psikike mbi popullatën shqiptare, sidomos te grua dhe fëmijë. Fillimi i asaj lufte frontale, ku rezistencën ma të madhe e bëri UÇK-ja dhe ne të gjithë ishim në mbështetjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bile mendimin, dhe ne në moshë të kapim pushkën dhe të dalim të luftojmë për çështjen e Kosovës edhe për lirin e një dhune të paparë që ushtronte regjimi i Millosheviqit, filloi nga Drenica 1998. Ne këtu në këtë pjesën tjetër qendra, Prishtina dukeshim se jemi të qetë, nuk ishim të qetë. Se aty i'a filloi, aty ishte rezistenca ma e madhe. Ndodhi ajo çka ndodhi me Jasharajt dhe për ne ishte aq brengosëse të ndodhte edhe nëpër pjesë tjera të Kosovës. Kështu që fillon të zbrazet Drenica, rrethi i Pejës dhe kryesisht Drenica.

Jam ulqinake me origjinë dhe për çdo verë unë shkojsha te familja ime. Mirëpo, me një organizatë që kom qenë iniciatore që të formohet "Anima", në krye me një gru, edhe të guximshme, edhe të fuqishme, kam pasë marrëdhënie permanente me të, ajo osht Zylfije Xhoni Duraku. Dhe edhe ata ishin t'u formu se diku plasi lufta e hapt, UÇK me forca të pabarabarta. Se ky ishte pushtues kurse UÇK-ja dhe rradhët e UÇK-së luftojshin për çlirimin e Kosovës. Ne ishim krejt popullata, brohoritshin UÇK dhe ishte shpresa ma e madhe që ne të çliroheshim edhe ashtu ngjau në fund. Dhe n'Ulqin, duke kontakti më shoqatën "Anima", fillon refugjatët nisën ka, diku ka Shqipëria të zhvendosen diku ka Ulqini e Mali i zi. Dhe me qindra familje strehohen në Ulqin, tre muaj une, Zylfijë Xhoni Duraku dhe profesoresha Mejreme Berisha, edhe ajo ishte ulqinake por edhe unë Ulqinake, unë me vjet jetojsha në Kosovë. Edhe Mejremi ishte në Kosovë dhe të triat u angazhuam bashkë me Fahri Buçincën, u angazhaum për strehimin e kryefamiljareve. Nuk pranonim familja që ishte me kryefamiljar mashkull, menonim që mashkulli duhet ta ketë venin e vetë në front dhe ishim fokusi rreth strehimit të grave me fëmijë. Burra, Burrat disa u deklarojshin që janë në rradhët e UÇK-së, disa kishin braktisë familjet, mirëpo ato familje që vishin si kryefamiljare vinte grua, aty ne punojshim.

Me qindëra fëmijë dhe gra i vendosnim në familje të ulqinakëve që durhapur i pranun. Pastaj, mërgimtarët pasi ishte koha e pushimeve vjen koha e mërgimtarëve, Ulqini ka shumë mërgimtarë në Amerikë, në Kanada, në Australi, në Evropë, u afrun grupit tonë për ndihma materiale, dhe ato ndihma materiale shkojshin në vendosjen e atyne fëmijëve, veshmbathje, ushqim. Kështu që tre muj shoqata "Anima" me grupin e veteranëve të arsimit jetun dhe strehun me qindëra fëmijë e gra në Ulqin. Mirëpo u donte që... ju e dini kosovarët kanë shumë vikendica në Pllazhën e Madhe dhe ato vikendica tash u kthejshin njerëzit se ke na nuk ngjante... pjesën e Kosovës për shembull me qenë n'Prishtinë nuk ngjau asgja. Nuk ishte fronti

direkt, ushtria dhe policia e Serbisë me pjesëtarët tonë të UÇK-së dhe u kthehnin njerëzt. I dhamë, unë e Fahriu pasi na ishim edhe kojshi atje dhe e dijsim kush ka vikendica, i dhamë urdhër, “S’guxon kërkush me marrë çelësin me veti. Çelësat e vikendicës me i’u dorëzu këtij komisioni”. Në atë komision sigurisht ishe une, Fahriu, Zyli dhe Mejremja.

U dorëzunë të gjithë çelësat e vikendicës. I strehum me dhjetëra familje, mund ta them që në vikendicën time qe një arsimtar me familjen e gjanë t’ij prej Komoranit. Ke doktor Muharrem Gashi, Emine Gashi po ashtu ke Sahit Lipa, ata që i kisha ma afër natyrisht, Talat Gjinolli, të gjithë ata i hapën dyert për të zhvendosurit tonë nga Drenica. Kshtu që ne kur arritëm, kur u kthyem në atë vikendicë të vikend-shtëpizave, kur u kthym në Prishtinë, u hap fronti komplet në tan Kosovën. Ne nuk kishim, nuk mrrijtëm që unë t’shkoj te prindët e mi në Ulqin, po u desh... me dhunë u zhvendosëm, kalum kufinin e Maqedonisë, e une me familje u zhvendosëm në Strugë me shumë t’tjerë kosovarë. Edhe shqiptarët e Maqedonisë krahëhapur na kanë pritë, t’jemi falemnderues shumë për atë çka banë gjatë luftës në Kosovë.

Ishte një tmerr që përjetoj secili fëmijë e secila gru, udhëtimi për zhvendosje asht’ një tregim i veçantë, trishtues. Pritnim çdo patrollë që takojshim, menonim që aty çdo gja do të përfundojë me ne. Mirëpo fati jem në familjen time unë shpëtova pa ndonji... natyrisht ishte dashtë me pagu secilin postbllok, ish dashtë pare me pagu. Me kënaqësi jepshin ato pare veç të shpëtonin. Dhe një herë, kur u nal një polic tha, “Ku po shkoni ju?”

## Ëndrrat

**Emine Berisha:** Naxhije për fund a keni ndonjë ëndërr që do të doni ta realizoni në të ardhmën?

**Naxhije Buçinca:** Po, krijmi i këtij fondit ka qenë andrra jeme. Pjesa e parë e kësaj andrre u realizu masi u kriju ky fond, po të ketë jetë të gjatë duke i’u falenderu donatorëve. Andrra jem është dhe ka qenë gjithmonë, edhe do të mundohem akoma ma tepër ta realizoj këtë andërr, kur në pushtet, kur në institucionet tona do të shkojnë 50-50. Në caqet vendim-marrëse do të kem gjithmonë femnat, sepse ne kemi tridhjet përqind kemi të drejtë në parlament, por edhe ajo tridhjet përqind për mu nuk është. Andrra jeme është që parlamenti jonë të ketë 50-50. 50 sikur në kohën kur gjermanët, ju e dini Gjermania është një shtet i forte, lokomotivë ekonomike në Evropë, me një kryeparlamentare Sismunt - është quajt. Ajo futi në parlamentin gjerman 50-50 gra dhe ku do të jenë ministresha, poashtu 50, besa nëse arrijmë t’i shkollojmë në shkollimet ma të larta dhe doktora të shkencës, bile ta tejkalojmë këtë 50-50 ta bajmë edhe gjashtë përqind.

Kështu që, kjo është andërr e jeme që gratë, vajzat që shkollohen, te shkollohen po të merren me, sidomos nga shoqëria civile është një etapë e shoqërisë civile dhe pastaj, si trampolinë të kalojnë në institucionet tona dhe femna të merret me politikë. Sepse heziton, heziton se natyra e femnës është e tillë, ajo heziton të merret se politika megjithatë don shumë kohë, po mendoj që do ta arrijmë edhe nivelin e jo intelektit, se ne kemi shumë meshkuj intelektualë dhe shkenctarë dhe krijues, po që me mbështetjen, edhe me mbështjetën e tyre femnat të arrijnë caqet më të larta në vendim-marrje.

Gëzohem që kemi një presidente, unë edhe atë ditë kur ishte promovimi i fondacionit për shkollimin e vajzave “Çifti Buçinca”, isha e entuziazmuar se një mirënjohje presidenciale për merita, ma dorëzoi një femër presidente.

**Emine Berisha:** Zonja Naxhije ju faleminderit shumë dhe ishte nder i madh për neve që ndatë kohën dhe treguat shumë histori të ndryshme, dhe për punën e juaj të palodhshme dhe ju falenderojmë për mikëpritjen tuaj.

**Naxhije Buçinca:** Ishte kënaqesi e imja sepse në këtë ekip nuk pash asnjë mashkull, po tri vajza të bukura, të zgjuta, dhe se çdo fjalë që e thoja ishte e aprovime nga ju dhe e pranimit që është një e vërtetë atë çka synoj unë me këtë fondacion.